



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Dr. Konstantinos Giakoumis

2. Prof. As. Dr. Sofia Delijorgji

Korrik/2024

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 435 / 03.09.1993
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASH Nr-4440.I-Prot- 18.07.2006
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Nuk ka
8	Cikli i studimit:	I
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Tre (3) vjet
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip dhe greqisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9/0
18	Numri i studentëve:	53
19	Komente / të tjera:	Nuk ka



## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Përshkrim përmbledhës**

Programi në proces të vlerësimit të jashtëm Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" (Niveli 6 në Kornizën Shqiptare dhe Europiane të Kualifikimeve) është licensuar me VKM Nr. 435 / 03.09.1993. Me Shkresë MASH Nr-4440.1-Prot-18.07.2006 programi i studimit u riemërua si Bachelor në "Gjuhë, Letërsi e Qytetërim Grek", me emërtim diplome: Mësues i Gjuhës dhe Qytetërimit Grek. Forma e regjistrimit të diplomës: Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek. Në sistemin e ASCAL-it emërtimi figuron sipas VKM-së dhe jo sipas emërimit të programit të studimit në Shkresës Nr. 585 Prot. dt. 19.05.2021 të MAS. Në këtë shkresë përcjellëse të dërgimit të informacionit për riorganizimin e programeve të studimit nën masën 20%, emërtesa e programit të studimit paraqitet si: "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek".

Edhe pse programi ka lëshuar diploma qysh prej vitit 1996, ky është vlerësimi i parë i tij për akreditim. Programi organizohet në tri vite studimi, me 180 ECTS nga Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, i cili operon brenda Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore të Universitetit të Gjirokastrës. Forma e studimit është me kohë të plotë, me prani fizike para dhe pas pandemisë, ndërsa gjuhët e instruksionit janë gjuha greke dhe gjuha shqipe. Staf i akademik në shërbim të këtij programi studimi përbëhet nga tetë (8) anëtarë të brendshëm, me kohë të plotë (një anëtar i shkëputur për arsye të interesit kombëtar) dhe zero (0) pedagogë të jashtëm.

Misioni i programit të studimit është dhënia e njohurive bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet lëndësh mësimore gjuhësore e letrare; rritja e kompetencave shkencore të studentëve në disipinat teorike për t'u përgatitur për arsimimin dhe trajnimin e mëtejshëm në fushën e mësuesisë në shkollat në gjuhën amëtare të minoritetit etnik grek apo edhe në shkolla të tjera në gjuhën greke në Shqipëri, për njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si edhe për një trajnim dhe parapërgatitje për kërkim të pavarur në fushën e gjuhësisë, letërsisë dhe qytetërimin grek, shkencave shoqërore, përkthimit dhe kritikës letrare (Evidenca 1.10. Rregullore e brendshme e programi Bachelor, Neni 6).

Studentët e programit që GVJ-a intervistoi vijnë kryesisht nga familje të minoritetit etnik grek të disa zonave të Gjirokastrës dhe nga emigrantë nga Shqipëria në Greqi që po riatdhesohen.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës

Procesi i vlerësimit të jashtëm ndoqi metodën e standardizuar në manualët dhe praktikat e ASCAL-it, të strukturuar në tri faza: faza e punimit në zyrë, faza e verifikimit në terren dhe faza e përfundimit të vlerësimit dhe hartimit të RVJ-së. Koordinator i ASCAL për këtë program vlerësimi është M.Sc. Aleksandra Xhamo.

### Faza I: Trajnimi i Ekspertëve dhe Studimi i RVB-së

Pas krijimit të Grupit të Punës, ekspertët e jashtëm u ftuan në një seancë trajnuese dhe plotësuan pjesën kontraktuale të punësimit të tyre. Pas dorëzimit të RVB-së së bashku me evidencat shoqëruese të tij, ekspertëve të jashtëm u akordua kohë e mjaftueshme për ta studiuar atë, me synimin që të formohej një pamje sa më e qartë mbi programin e studimit nën vlerësim, pikat e forta dhe pikat që paraqisnin nevoja verifikimi në terren. P.sh. ndërsa përputhja e misionit të programit me misionin e Departamentit, Fakultetit dhe institucionit prej të cilit programi ofrohet ishte i qartë, numri dhe kualifikimet e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm paraqitej të ishte jo-konform parashikimeve ligjore për disa vite, rrjedhimisht u shënua si pikë për verifikim në terren.

### Faza II: Verifikimi në Terren

Pas përcaktimit të datave dhe axhendës së vizitës dy-ditore në institucionin ofrues të programit të studimit nën vlerësim për akreditim, GVJ-a, i shoqëruar nga eksperti i akorduar prej ASCAL-it kreu vizitën për të ballafaquar gjetjet e fazës I me realitetin në terren. Aty, u realizuan si inspektimi i ambienteve që përdor programi, ashtu edhe një sërë takimesh:

1. Me Dekanin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, për të marrë mendimin mbi këtë program studimi, perspektivat e tij dhe rolin e Departamentit ofrues në strategjinë e zhvillimit të fakultetit, si edhe me drejtuesin e departamentit mbi këto.
2. Me GVB-në, për të verifikuar gjithëpërfshirjen, lirinë e veprimit dhe gjykimin të tij, si çfarë ka mësuar në procesin e vetë-vlerësimit dhe si qëllohet të kapitalizohet mbi njohuritë e përfutuara në këtë proces. Rol të rëndësishëm u akordua këtu në marrjen e mendimeve të studentës e cila u përfshi në procesin e vetë-vlerësimit.
3. Me personelin akademik të programit të studimit për të verifikuar kryesisht nivelin e përhapjes së kulturës të cilësisë që përshkruhet në RVB-në.
4. Me studentët e programit të studimit për të vërtetuar përfshirjen e tyre në procesin e vlerësimit të brendshëm, nivelin e pjesëmarrjes së tyre në çështjet me interes studentor të departamentit, si edhe për të konstatuar nivelin e efikasitetit të proceseve të komunikimit të departamentit me studentët e tij dhe nivelin e fuqizimit të tyre. Përfshirja edhe e disa të diplomuarve (anëtarë të personelit akademik) qoftë edhe për tej ciklit të vlerësimit i dha mundësinë GVJ-së për të parë ‘produktin’ e programit të studimit, për të konstatuar nivelin e përmbushjes së misionit të programit.
5. Me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, për të vërtetuar nivelin e ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të tij në monitorimin e kulturës së cilësisë në këtë program studimi.

6. Me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë të Fakultetit për të parë rolin dhe kontributin e departamentit të programit të studimit nën vlerësim në të.
7. Me instanca të mbështetjes administrative (Burime Njerëzore dhe Sekretaria Mësimore) për të parë nga afër mënyrën e operimit të tyre në funksion të këtij programi studimi.

### **Faza III: Finalizimi i RVJ-së**

Sinteza e gjetjeve të dy fazave të para u krye në këtë fazë të tretë, duke marrë parasysh edhe evidencat – shtesë që u dorëzuan nga institucioni pas kërkesës së GVJ-së.

Koha dhe kushtet qenë të mjaftueshme për të krijuar një opinion të mirë evidentuar për të hartuar një raport objektiv, të mbështetur në evidencat e paraqitura apo të gjeneruara gjatë gjithë këtyre fazave.

Më datë 28.05.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 85/21 Prot., datë 28.05.2024, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 11.06.2024, dhe me shkresë zyrtare Nr. 95 Prot., datë 10.06.2024 institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

### **GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:**

Vërejtjet, prapësimet dhe kundërshtimet e departamentit fillojnë me një hyrje të bollshme 7-faqëshe, e cila nuk shton as heq fuqinë argumentuese të pjesës thelbësore të komenteve. Mirëpo, duke qenë se hedhin dyshime mbi vetë objektivitetin e RVJ-së, Grupi i Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm e ndjen të nevojshme të ndalet në përmbajtjen e hyrjes aq pak sa t'i shërbëjë mandatit të tij.

#### **I. Pretendimet për tendencat me motiv konfliktin e interesit.**

Raporti me komentet e Departamentit mbi RVJ-në fillon me pretendimet për tendenca të ekspertëve të jashtëm me motiv konfliktin e interesit (f. 4). Siç personalizohet në komentet, njëri prej ekspertëve të jashtëm (Prof.As. Dr. Konstantinos Giakoumis) është i punësuar në sektorin privat të Arsimit të Lartë në Shqipëri, rrjedhimisht “ai shpesh ka manifestuar interesin dhe përpjekjet e drejtuesve të kësaj kategorie arsimit në Shqipëri, për përvalimin e shkollave private në gjuhën greke, mbi ato publike në gjuhën greke” (f. 4). Madje edhe pohimi në f. 5 se “nuk shprehëm që në fillim refuzimin tonë për të”, në kushtet kur, pasi ekspertët e jashtëm u propozuan IAL-së, departamenti i pranoi ata, dëshmon, sipas grupit të ekspertëve, mungesë të kulturës së debatit, kritikës dhe sintezës. Kjo nuk është e papritur për njësi apo programe studimi që sapo hyjnë në veprimtarinë e akreditimit.

Ndarja midis arsimit të lartë publik dhe privat në Shqipëri dhe përtej është tashmë e tejkaluar për shkak të zhvillimeve teknologjike dhe ekonomike globale që kërkojnë bashkëpunim dhe adoptim praktikash të mira nga të dy sektorët. Modelet hibride të arsimit, që përfshijnë programe të përbashkëta dhe bashkëpunim ndër-institucional, kanë bërë që çfarë shihej si kufi më përpara të zhduket. Përqendrimi në aftësitë dhe punësimin e ka zhvendosur vëmendjen nga struktura financiare në cilësinë e programeve, ndërsa mobiliteti akademik dhe

globalizimi kanë homogjenizuar standardet arsimore. Si rezultat, përqendrimi duhet të jetë në cilësinë e arsimit dhe përvojën e studentëve, pavarësisht nga statusi publik ose privat i institucionit.

## **II. Karakteri i rekomandimeve të GVJ-së.**

Njësia bazë organizuese e programit të studimit nën vlerësim paraqitet sikur të ketë keqkuptuar karakterin e rekomandimeve të grupit të ekspertëve të jashtëm. Është e nevojshme të ndërgjegjësohet se rekomandimet e ekspertëve të jashtëm në thelb janë thjesht sugjerime dhe ftesa për një njësi bazë të reflektojë mbi efektshmërinë dhe mençurinë e politikave dhe praktikave që kanë drejtuar operacionet e saj, duke shërbyer kështu si nxitës të ndryshimit për të ardhmen. Këto rekomandime ofrojnë një perspektivë të jashtme që inkurajon institucionet të rishikojnë dhe të përmirësojnë qasjet e tyre ekzistuese, duke identifikuar mundësi për përmirësim dhe inovacion. Përmes këtij procesi reflektimi, institucionet kanë mundësinë të analizojnë kritikën dhe sugjerimet në një kontekst më të gjerë strategjik, duke kuptuar se si mund të përmirësojnë efektivitetin dhe efikasitetin e tyre. Kjo jo vetëm që ndihmon në adresimin e dobësive të mundshme, por gjithashtu nxit një kulturë të vazhdueshme të përmirësimit dhe përsosjes. Duke u angazhuar në këtë proces, institucionet mund të sigurojnë që politikën dhe praktikën e tyre të jenë në përputhje me zhvillimet moderne dhe kërkesat e një shoqërie dinamike, duke garantuar kështu një zhvillim të qëndrueshëm dhe të suksesshëm në të ardhmen.

## **III. Cilësia në një program studimi është përgjegjësi kolektive.**

Kultura e fragmentimit të një entiteti të vetëm duket se minon rolin dhe përgjegjësitë e grupeve dhe individëve që bashkëpunojnë në një përpjekje kolektive. Cilësia e një programi studimi varet nga disa grupe që punojnë së bashku për të arritur qëllime të përbashkëta. Ndaj, ndarja e përgjegjësisë të 'menaxhimit' të programit të studimit nga përgjegjësitë e 'institucionit' ose 'organeve superiore' (d.m.th., trupat vendimmarrëse kolegjiale në një nivel më të lartë se ai i Departamentit), sikundër paraqitet në Pikën e të f. 7, është absurde në këtë rast, pasi grupi i ekspertëve të jashtëm vlerëson cilësinë e programit të studimit që po shqyrtohet dhe jo performancën e ndonjë prej grupeve ose individëve që punojnë së bashku në realizimin e programit të studimit. Për të siguruar një cilësi të lartë të programit, është thelbësore që të gjithë aktorët përkatës të bashkëpunojnë në mënyrë të harmonizuar, duke ndarë përgjegjësitë dhe duke punuar drejt qëllimeve të përbashkëta. Vetëm përmes një përpjekjeje kolektive dhe të bashkërenduar mund të arrihet ekselencia akademike dhe të sigurohet që studentët të marrin një arsimim të cilësisë më të lartë.

**Në lidhje me pjesën përmbajtësore të komenteve:**

### **1. Lidhur me komentën e institucionit për Standardin I.1, Kriteri 1,**

GVJ-ja sqaron se, ndërsa kriteri i përket mënyrës së të operuarit të institucionit, duke qenë se akreditimi është në nivel programi studimi, GVB-ja argumenton mbi përmbushjen e kriterit nga programi i caktuar nën vlerësim. GVJ-ja mbetet i mendimit se të argumentuarit se si programi u shërben (dhe rrjedhimisht nuk bie ndesh) interesave kombëtare pikërisht për specifikat e departamentit nuk është i vetëkuptueshëm. Madje, nga shënimet e takimit me pedagogët e programit të studimit dilte se vetë pedagogët ishin të ndërgjegjshëm se kontribuonin në kryerjen e detyrimeve të vendit karshi minoritetit etnik grek. Megjithatë, duke qenë se kjo nuk është pjesa më thelbësore e RVJ-së, pranon ta ndryshojë raportin.

**Raporti në këtë pikë ndryshon duke u shkurtuar.**

**2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.1, Kriteri 4,**

GVJ-ja sqaron se periudha e vlerësimit për akreditimin e parë të programit të studimit nën shqyrtim nuk ka qenë viti i fundit akademik, por të paktën tre, kujton se lista e personelit akademik e paraqitur nga vetë institucioni në RVB-në qe dëshmi se Departamenti nuk përmbushte minimale standardet ligjore dhe se, me kërkesë të GVJ-së, institucioni dorëzoi një listë të përditësuar të personelit akademik, ku kërkesat minimale ligjore për personelin akademik përmbusheshin. Mospasja e të paktën tre pedagogëve me “me grada shkencore ose tituj akademikë” (LAL Nr. 80 / 2015, Neni 25, Pika 4) për disa vite rradhazi nuk përbën dëshmi konsolidimi. GV-ja ka përgëzuar dinamikën pozitive të zhvillimit të tre anëtarëve të personelit akademik të departamentit me regjistrimin e tyre në shkollat doktorale dhe ka evidentuar edhe përmbushjen e kërkesës së numrit minimal të personelit akademik me tituj dhe grada që nga viti akademik 2023-2024, por nuk është bindur se këto zhvillime pozitive përbëjnë provë konsolidimi të Departamentit përgjatë gjithë periudhës së vlerësimit. Rrjedhimisht,...

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.1, Kriteri 5,**

GVJ-ja mendon se kodi i propozuar i programit të studimit (63BA9999X) nuk paraqitet i bazuar në VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 “Për Specifikimin dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit...”, pasi në këtë akt nuk ka fushë me kod 9999, ndërsa fusha 099 i përket fushës së shëndetit dhe mirëqënies, e cila nuk përkon me programin e studimit nën vlerësim. Sugjerimi se kodi “9999”, i paparashikuar në aktet normative në fuqi, i referohet një fushë të panjohur diku tjetër (komentet, f. 11) nuk paraqitet bindës për GVJ-në, pasi programi i studimit paraqet ngjashmëri me dy programe të IAL-ve të tjera brenda Shqipërisë, si edhe disa programeve simotër nëpër botë. Përfshirja e departamentit në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore me njësi të tjera bazë në fushat e edukimit, gjuhëve dhe shkencave humane dhe shoqërore orienton drejt një kodifikimi nëpër fushat e ekspertizës së njësive kryesore, mirëpo është kompetencë e vetë institucionit, brenda suazës së autonomisë, ta propozojë kodin dhe ministrisë përkatëse të pozicionohet mbi propozimin e institucionit. Për sa i përket Kriterit Nr. 5, GVJ-së nuk i dukën bindëse komentet, prandaj...

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**4. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin I.1.**

Te Kriteri Nr. 4 GVJ-ja ka qenë i mendimit se shkalla e përmbushjes ka qenë e pjesshme (përmbushet pjesërisht) dhe jo në pjesën kryesore (përmbushet kryesisht), siç është shënuar në komentet. Për disa vite rradhazi titullarë të lëndëve të ofruara nga departamenti nuk kanë pasur, me raste ende nuk i kanë, kualifikimet e duhura nga aktet normative në fuqi (titull akademik apo gradë shkencore) sipas konceptit të Shtojcës Nr. 3 të VKM-së Nr. 41 / 24.12.2018, të ndryshuar. Rrjedhimisht, GVJ-ja mendon se vlerësimi është i mjaftueshëm dhe...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**5. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin I.2, Kriteri 1.**

Në komentet e institucionit pohohen konstatimet e GVJ-së, i cili është futur ‘hulumtimeve dhe përlllogaritjeve të thella’, siç cilëson raporti i komenteve (f. 13), pasi kjo është çfarë kërkohej në këtë kriter. Ndryshimi i kurrikulave në masën deri më 20% nuk kërkon miratim, por njoftimin e Ministrisë brenda afate ligjore, pra rishikimi i kurrikulave është lënë brenda kornizës së autonomisë universitare. Rrjedhimisht, pretendimi i raportit të komenteve se programi i rishikuar gëzon aprovimin e MAS-it, ndërsa devijimet e vogla tolerancën e saj nuk është i bazuar. Ndërkohë, ndërlidhja e vlerësimit të këtij kriteri me vlerësimin e Kriterit Nr. 3 (f. 13) dhe habia pse vlerësimi i tyre nuk është i harmonizuar nuk cilësohet si e bazuar, duke qenë se te Kriteri Nr. 1 kërkohet pozicionim nga ekspertët në lidhje me pyetjen sa struktura dhe elementet e programit të studimit janë në përputhje “me legjislacionin vendas në fuqi”, ndërsa Kriteri Nr. 3 i kërkon ekspertëve të argumentojnë mbi qartësinë e përcaktimit të “veprimtarive formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.” Pra, ndërsa përcaktimi i veprimtarive formuese, të grupuara, është i qartë, mbetet jo konform parashikimeve ligjore. Prandaj,...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**6. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin I.2, Kriteri 2 dhe 4.**

GVJ-ja nuk pajtohet as me komentin se kriteri është evaziv (f. 13), as me sugjerimin e pambështetur të komenteve (f. 14) se “dihet se mundësitë e punësimit me diplomë Bachelor janë të minimizuara”. Madje shqetësohet: 1. për se departamenti nuk ka thëlluar në arsyet që arrin në këtë konkluzion; 2. për se programi i studimit nuk merr përsipër t’i pajisë studentët me njohuri dhe kompetenca në mënyrë që ata të jenë të zotë në “zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale”, pritja kjo e Kriterit Nr. 2. Theksohet këtu se parashikimi i praktikave profesionale është detyrim ligjor sipas konceptit të Shtojcës Nr. 1 të VKM-së Nr. Nr. 41 / 24.12.2018, të ndryshuar, dhe parashikohet edhe te cikli i parë i studimeve në nivel Bachelor. GVJ-ja mirëkupton se mungesa e parashikimit të praktikës profesionale është vendim institucional me zbatim më të gjerë se programi i studimit nën vlerësim, por fton departamentin e programit të studimit të peshojë avantazhet e praktikës profesionale në mënyrë që mundësitë e punësimit me diplomë Bachelor të mos jenë të minimizuara. Prandaj,...

**Vlerësimi në këtë pikë ndryshon duke shtuar frazën e fundit të paragrafit të mësipërm në trupën e raportit, te Kriteri Nr. 2.**

**7. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin I.2, Kriteri 6.**

GVJ-ja shënon se pritja e kriterit për ngjashmëri në masë të paktën 70% të programit të studimit Bachelor me programe të tjera që ofrohen në të njëjtën fushë studimi (Kriteri 6) është e bazuar te Neni 86, Pika 6 të Ligjit Nr. 80 / 21.05.2015, të ndryshuar mbi Arsimin e Lartë. Prandaj,...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**



**8. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin I.2, Kriteri 7.**  
Arsyetimi i RVJ-së mbi komentet për Standardin I.1, Kriteri 5, qëndron edhe këtu. Prandaj,...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**9. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin I.2.**  
Përpos komenteve të ngritura më sipër, komentet përmendin një “fakt ligjor se në programet Bachelor që nuk parashikojnë një specifikim profesional nuk mund të përfshihen praktika profesionale” (f. 15), por nuk e citojnë atë ‘fakt ligjor’.

Jemi i mendimit se qëndrimi që në programet Bachelor që nuk parashikojnë ndonjë specifikim profesional nuk mund të përfshihen praktika profesionale është i gabuar për disa arsye. Së pari, praktikat profesionale ofrojnë studentëve një përvojë të vlefshme që shkon përtej teorisë së mësuar në auditor. Ato i lejojnë studentët të zhvillojnë aftësi praktike, të kuptojnë më mirë tregun e punës dhe të krijojnë lidhje profesionale që mund të jenë thelbësore për karrierën e tyre të ardhshme. Edhe nëse një program Bachelor nuk ka një fokus të specifikuar profesional, përfshirja e praktikave profesionale ndihmon në përgatitjen më të mirë të studentëve për sfidat reale të tregut të punës. Së dyti, tregu i punës është gjithnjë e më kompleks dhe kërkon nga të diplomuarit një gamë të gjerë aftësish dhe përvojash. Një program arsimor që nuk përfshin praktika profesionale rrezikon të prodhojë të diplomuar me njohuri të kufizuara në teori dhe pa aftësitë e nevojshme praktike. Duke përfshirë praktikat profesionale, edhe në programet pa specifikim profesional, universitetet mund të sigurojnë që studentët e tyre të jenë më të përgatitur dhe më të adaptueshëm ndaj kërkesave të ndryshme të tregut të punës, duke rritur kështu perspektivat e tyre për punësim dhe sukses në karrierë.

Rrjedhimisht, GVJ-ja mendon se vlerësimi i dhënë më parë është i mjaftueshëm dhe...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon, me shënimin se, nëqoftëse institucioni paraqet fakt ligjor mbi pretendimin e mësipërm (pra se praktika nuk mund të përfshihet në programe Bachelor pa specifikim profesional), GVJ-së do t'i duhet të rishikojë vlerësimin.**

**10. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.2, Kriteri 1.**  
Pikë së pari, GVJ-ja sqaron se çfarë u cilësua si e pamjaftueshme nuk ishte rregullorja e programit të studimit, por evidencat e cituara në RVB-në mbi “përmbushjen [nga ana e Fakultetit dhe Departamentit] e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin”, element që nuk realizohet vetëm nëpërmjet një rregulloreje. Pikë së dyti, GVJ-ja nuk ka as tagrën as mandatin të konstatojë shkelje ligjore, siç gabimisht shkruhet në f. 16, Pika 3. GVJ-ja konstatoi se që të gjithë anëtarët e departamentit janë të ngarkuar me shumë orë suplementare (jo-rrallë edhe të papaguara) dhe, për disa prej tyre, në një numër relativisht të madh disiplinash, përtej ekspertizës së dëshmuar përmes gradave shkencore dhe prodhimit të kërkimor-shkencore. Pohimi në fund të f. 16 të komenteve se “trajtesa të kulluara akademike e manaxhuese nuk ka mundësi reale të zbatohen” tregon si potencialin e rritjes së cilësisë në programin e studimit përmes pasurimit dhe rritjes së personelit akademik, ashtu edhe nivelin e ndërjegjësimit të

njesisë bazë organizuese. Në lidhje me pikën Nr. 4 të komenteve (f. 17) se “Çështja e NjSBC-së ... nuk ka për se t’i ngarkohet kësaj Njësie”, GVJ-ja sqaron se, në frymën e Pikës III t’përgjithshme në fillim të këtij raporti, cilësia e një programi studimi është përgjegjësi kolektive, pasi varet nga disa grupe që punojnë së bashku për të arritur qëllime të përbashkëta. Prandaj, për të siguruar një cilësi të lartë të programit, është thelbësore që të gjithë aktorët përkatës të bashkëpunojnë në mënyrë të harmonizuar, duke ndarë përgjegjësitë dhe duke punuar drejt qëllimeve të përbashkëta. Në frymën e ndarjes së përgjegjësive, është e vetëkuptueshme se çështjet operacionale të NjSBC-së nuk mund të ngarkojnë departamentin, mirëpo fakt mbetet se ndikojnë në cilësinë e programit të studimit. Prandaj,...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

#### **11.Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.2, Kriteri 3.**

GVJ-ja pranon se, për arsye të numrit modest të studentëve të programit të studimit dhe të marrëdhënieve që kanë me pedagogët e tyre, rekomandimi për caktimi nga ana e Departamentit të një koordinatori për secilin program studimi “nuk gjen terren për t’u zbatuar” (f. 17) në të tashmën, por vazhdon me mendimin se një rritje e numrit të studentëve në të dy programet e studimit do ta kthente çështjen e koordinatorit në domosdoshmëri. Prandaj,...

**Vlerësimi në këtë pikë ndryshon.**

#### **12.Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.2.**

GVJ-ja u bind nga komentet mbi vlerësimin e Standardit II.2, Kriteri 3. Rrjedhimisht, GVJ-ja ndryshon lërsimin e këtij kriteri nga “përmbushet kryesisht” në “përmbushet plotësisht”, mirëpo ky ndryshim në mendimin tonë nuk është i mjaftueshëm për të përmirësuar vlerësimin e standardit, pasi çështjet e konstatuara në lidhje me ngarkesat dhe ekspertizat e personelit akademik, si edhe çështjet e funksionimit të NjSBC-së nuk lejojnë vlerësim maksimal. Prandaj

**Vlerësimi këtu ndryshon pjesërisht.**

#### **13.Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.3.**

GVJ-ja nuk pajtohet me komentin se programi i studimit nën vlerësim “mund të japë [n.b. fjalia duhet kuptuar si “NUK mund të japë” diploma për punësim të drejtpërdrejt dhe në mënyrë konkurruese në tregun e punës]” (f. 17). Mendojmë se mungesa totale e orientimit profesional në këtë program studimi mund të jetë edhe ndër arsyet e numrit modest apo të ulët të studentëve. Programet e studimeve në Gjuhë, Qytetërim dhe Kulturë ofrojnë disa mundësi punësimi për të diplomuarit në profesione të parregulluara. Këto programe pajisin studentët me aftësi të gjera ndërkulturore dhe gjuhësore, të cilat janë të vlefshme në fusha të ndryshme si turizmi, shërbimet ndërkombëtare, media, dhe komunikimi. Përveç kësaj, të diplomuarit mund të punojnë si përkthyes të niveleve që nuk kërkojnë licencë, konsulentë kulturorë, menaxherë projektsh, ose në organizata joqeveritare që operojnë në kontekste ndërkombëtare. Këto aftësi të transferueshme krijojnë një bazë të fortë për karrierë në një treg pune global dhe të larmishëm. Prandaj, i sugjerojmë Departamentit të reflektojë mbi këto mundësi në të ardhmën.

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

#### **14.Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.4, Kriteri 1.**

Së pari, GVJ-ja me keqardhje vëren shtrembërimin e konstatimit të tij se “orientimi i programit të studimit në shërbim të edukimit të minoriteti etnik grek të zones ka prodhuar domosdoshmërinë për disa lëndë të Pedagogjisë”, i cili u keqinterpretua si “rekomandim urdhërues” (f. 17). Sqarron se konstatimi u përfshi për të racionalizuar realitetin e përfshirjes së disa lëndëve të Pedagogjisë në kurrikulat ekzistuese dhe jo për të sugjeruar shtimin e këtyre lëndëve. Në lidhje me strukturën e kurrikulave dhe fushave kurrikulare që mbulohen, GVJ-ja pranon arsyetimin e komenteve dhe sqarron se mejtimet e tij në këtë kriter mund të merren parasysh në rishikimin e kurrikulave të programit të studimit, gjithmonë nëqoftëse njësi bazë organizuese i cilëson të dobishme. GVJ-ja qëndron në mendimin se “lypset një rishikim i kurrikulës së programit të studimit, në të cilin të merren parasysh edhe konstatimet” dhe kupton se është përgjegjësia e vetë Departamentit, në kuadrin e lirisë akademike dhe autonomisë, të gjykojë nëqoftëse do t’i marr parasysh konstatimet e GVJ-së dhe, nëse po, si. Prandaj,...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

#### **15.Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.4, Kriteri 4.**

Raporti me komentet e departamentit sugjeron se ana praktike si mundësi formimi profesional i përket vetëm programve të studimit të cilësuar si profesional. GVJ-ja mendon se kurrikula me disa qasje të balancuara praktike nuk janë të vlefshme vetëm për programe të formimit profesional. Aftësitë praktike janë të rëndësishme për zhvillimin e përgjithshëm të studentëve dhe përgatitjen e tyre për jetën reale. Përvoja praktike ndihmon në zbatimin dhe përforcimin e njohurive teorike, rrit kreativitetin dhe aftësinë e zgjidhjes së problemeve, dhe nxit ndërveprimin shoqëror dhe bashkëpunimin. Aftësitë praktike janë të vlefshme në çdo fushë studimi dhe mund të kontribuojnë në një shoqëri më të mirë dhe më të aftë për të përballuar sfidat e ndryshme. Prandaj, qasja praktike mendojmë është mirë të integrohet në të gjitha llojet e programeve arsimore për të përgatitur studentët për një të ardhme më të suksesshme dhe më të plotë. Megjithatë, GVJ-ja i sugjeron njësisë bazë të reflektojë mbi këtë çështje.

Argumenti tjetër se, në kushtet që “niveli real i studentëve në vitin e parë është i ulët dhe impenjimi i ulët, mbizotërimi i ngarkesës teorike krijon mundësi të përfitimit të dijeve të munguara dhe të reja dhe **i hap rrugën anës praktike**” në kombinim me sugjerimin se “shtimi i detyrimeve praktike nuk nxit studentin për rritjen e frekuentimit” nuk paraqitet bindës për GVJ-në. Vetë Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë, në bazë të të cilit u caktuan kriteret e formularit të RVB-së dhe të RVj-së, parashikon atë element praktik. Nga evidencat e kërkuara me kampion gjatë vizitës në institucion u dorëzuara procesverbali i notave të provimit të Semestrit II “Teknologji të Reja në Komunikim” (“Evidencë shtesë - kampion i vlerësimit me notë.pdf”) – lëndë që figuron me emertesën “Hyrje në PC dhe teknologji të reja” në planin respektiv mësimor (Evidenca 3.1 Plan Mesimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek) konstatohet nga mungesa e frekuentimit të të gjithë tetë (8) studentëve gjatë leksioneve dhe seminareve (nuk ka notë për komponentin e vlerësimit të vazhduar), si edhe provimeve (nota “nuk ka frekuentuar”) se as mbizotërimi i ngarkesës teorike nuk ka nxitur studentët të frekuentojnë. Prandaj, njësi bazë mbase mund të reflektonte për ndonjë ndryshim të raportit midis teorisë dhe praktikës në një lëndë të tillë.

Për sa më sipër, GVJ-ja mbetet i mendimit se raporti midis formimit teorik, aplikativ dhe praktik nuk cilësohet i balancuar, pasi nuk i paraqitet t'i shërbejë aftësimi praktik të studentëve, rrjedhimisht...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**16. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.4, Kriteri 7.** VKM Nr. 41 / 24.12.2018 “Për Elementet e Programeve të Studimit...”, i ndryshuar, në Shtojcën Nr. 1 të tij përcakton se komponenti mësimor “Lëndë plotësuese” që i përket Kategorisë D të lëndëve përmban si “gjuhë të huaja, njohuri informatike”, ashtu edhe “praktika profesionale”. Rrjedhimisht...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**17. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.5, Kriteri 1.** GVJ-ja, duke qenë se raporton në bazë evidencash, do të donte të shqyrtonte evidenca të reja dhe të mirëfillta mbi procedurat e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjes sa më mirë të tij me kërkesat e tregut të punës dhe mënyrën se si njësia përgjegjëse është konsultuar dhe ka marrë parasysh propozimet e institucioneve partnerë, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. Evidenca e vetëm e cituar në RVB-në është një përmbledhje të një projekti ERASMUS+ për ndërtimin e kapaciteteve me synim **zhvillimin e kompetencave të mësuesve për një sistem të gjithanshëm të arsimit dhe formimit profesional** (Evidenca 2.5.1 Teavet). Nga evidenca nuk del as roli i departamentit në këtë projekt, as mënyra se si kjo përvojë mund të ketë ndikuar në reflektimet e departamentit mbi programet e tij të studimit, përfshi edhe elementin praktik. Përsderisa evidenca të mirëfillta nuk u paraqitën as në raportin e komenteve...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**18. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.5, Kriteri 2.** Raporti i komenteve (f. 21) sugjeron se, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit, diskutimi me studentët dhe strukturat e tyre dhe konsultimi i vazhdueshëm me studentët e diplomuar është përgjegjësi e UGJ-së dhe jo e departamentit. GVJ-ja nuk pajtohet me këtë sugjerim, sepse përmirësimi i programit të studimit është përgjegjësi e përveçme e njësisë bazë brenda suazës së autonomisë akademike që lejon ligji. Rrjedhimisht...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**19. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.5, Kriteri 3.** Raporti i komenteve (f. 22) i kërkon GVJ-në t'i rekomandojë rrjete profesionistësh, shoqatash ... dhe institucione publike e private me të cilët mund të bashkëpunohet. GVJ-ja mendon se mungesa e praktikave profesionale që detyrojnë partneritete të tilla mund ta ketë shkëputur departamentin nga rrjete të tilla. GVJ-ja sugjeron se një fillim i mirë i krijimit të kontakteve të tilla mund të bëhet, me të tjerësh, me operatorët e ndryshme të turizmit, me shoqatat kulturore

të rrethit dhe sidomos të minoriteti dhe me shkollat e zonës. Duke qenë se raporti i komenteve nuk sjell asnjë evidencë mbi mënyrën se si partneritetet që citohen kanë bashkëpunuar në përmirësimin e kurrikulave,

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**20. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin III.**

Vlerësimi i lartë i këtij standardi e ka çuar departamentin në mosparaqitjen e rezervave dhe prapësimeve për këtë standard. GVJ-ja i sugjeron departamentit të reflektojë mbi sugjerimet e tij si në këtë standard, ashtu edhe në standarde të tjera për përmirësimin e vazhdueshme të cilësisë në këtë program studimi. Duke qenë se nuk kërkohet ndryshim në këtë standard...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**21. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin IV.1.**

GVJ-ja vlerëson pozitivisht faktin se që nga viti akademik 2022-2023 tre anëtarë të departamentit janë të regjistruar në programe të doktoraturës. Megjithatë, për vlerësim më të lartë GVJ-ja do të donte: **I.** një përpjekje sistematike drejt publikimit të punimeve shkencore të personelit akademik në revista të indeksuara dhe të renditura në bazë të kriterëve si Clarivate Analytics (ish-Thomson/Reuters), SCOPUS, apo libra/kapituj të botuar në shtëpi botuese të renditura në SENSE Academic Publishers, duke qenë se kjo do të ndihmonte edhe në promovimin e tyre në tituj akademikë (nuk ka publikime të tilla deri më sot); **II.** një përpjekje më sistematike dhe të targetuar për gjetjen e burimeve të reja njerëzore për departamentin, pasi fakti që Zyra e Burimeve Njerëzore kishte shpallur vende vakante disa herë, por nuk ishin paraqitur kandidatë, siç dëshmoi edhe përfaqësuesja e kësaj zyre, përbën rrezik për qendrueshmërinë e burimeve njerëzore akademike të Departamentit. Rrjedhimisht...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**22. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin IV.2.**

Nuk kërkohet ndryshim vlerësimi. Rrjedhimisht...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**23. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin IV.3.**

Edhe pse vlerësimi këtu që i lartë, pajisja dhe përdorimi i pajisjeve për t'i ardhur në ndihmë studentëve me paaftësi përbën vërejtje shumë serioze, aq më tepër duke marrë parasysh se departamenti ka patur dikur një student të verbër, i cili ndërpreu studimet në UGJ për shkak të mungesës së aksesueshmërisë së studimeve. Fakti që përgjegjësia nuk është vetëm e departamentit por edhe e gjithë IAL-së nuk e zbut mungesën e këtij elementi kaq delikat për cilësinë në programit e studimeve. Rrjedhimisht...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

**24. Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin IV.4.**

Rekomandimi e GVJ-së për përmirësimin e sistemit elektronik për të rritur efikasitetin dhe përshtatshmërinë e tij, sidomos për sigurimin e një përdorimi optimal të bibliotekës digjitale dhe përshtatjen e platformave elektronike për të mbështetur raportimet individuale dhe monitorimin në kohë reale qëndron. Megjithatë, rivlerëson standardin dhe...

**Vlerësimi në këtë pikë ndryshon nga “përbushet kryesisht” në “përbushet plotësisht”.**

**25. Lidhur me komentet mbi vlerësimin e GVJ-së për Standardin IV.**

Ndryshimi i vlerësimin në pikën 24 sjell edhe këtu një ndryshim. Rrjedhimisht ...

**Vlerësimi në këtë pikë ndryshon nga “përbushet kryesisht” në “përbushet plotësisht”.**

**26. Lidhur me komentet mbi vlerësimin e GVJ-së për Standardin V.**

Nuk kërkohet ndryshim raport. Rrjedhimisht ...

**Vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.**

Për sa më sipër, edhe pse shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit modifikohet si vijon, përmasat e problematikave të evidentuara në fushat e standardeve I, II dhe VI, si edhe një fare mungese e kulturës së cilësisë, e dëshmuar nga moskuptimi se cilësia në një program studimi është shumëfaqëshe dhe disa faqe nuk lidhen ekskluzivisht me departamentin, e kanë bindur GJV-në se vlerësimi tërësor se shkalla “kryesisht” e përbushjes së standardeve të cilësisë është e mjafteshme. Prandaj vlerësimi në këtë pikë nuk ndryshon.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në shtjellimin e këtij kriteri RVB-ja argumentoi se programet e ofruara prej institucionit jo vetëm nuk bien ndesh me interesat kombëtare, por edhe u vihen në shërbim të atyre. Pohimi mbështetet te Statuti i IAL-së (Evid. 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 5) dhe te Strategjia e Zhvillimit Institucional (Evid. 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej, 2020-2025, Pika 3). Për më tepër, institucioni tregoi bindshëm ligjshmërinë e programeve të studimeve të ofruara, përfshi edhe programin konkret të studimit nën vlerësim (VKM Nr. 435 / 03.09.1993 dhe Shkrese MASH Nr-4440.1-Prot-18.07.2006).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	RVB-ja argumenton se programi i studimit është në përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit (Evid. 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Nene 4, 5 dhe 8) dhe është i integruar në strategjinë institucionale (Evid. 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej, 2020-2025, f. 8). Ky argumenti iu duk i bindshëm GVJ-së.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	RVB-ja pretendon pëmbushjen e plotë të këtij kriteri në bazë të misionit të institucionit (Evid. 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 5 dhe Evid. 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej, 2020-2025, f. 8) edhe seksionin C (op. cit., Seksion C) të strategjisë, pa specifikuar se te f. 9 theksohet orientimi i universitetit drejt zhvillimit të rajonit të Gjirokastrës. Njëkohësisht, RVB-ja parashton në mënyrë të detajuar bazën rregullative mbi të cilën është hartuar dhe organizuar. GVJ-ja është e bindur nga argumentet e dhëna.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	RVB-ja argumenton se “institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e programit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek”, duke u mbështetur te vjetërsia e institucionit (Evidenca 1.1.5. Vendimi i hapjes së ILP-së) dhe te akreditimi institucional i tij (Vendim Bordi Akreditimi Nr. 55 / 16.12.2021).  <i>GBJ-ja vëren se asnjë nga evidencat e mësipërme nuk i përket fushës akademike specifike nën vlerësim në mënyrë të drejtpërdrejt. Lista e përditësuar e personelit akademik (Evidencë Nr. 1 shtesë) paraqet përpjekjet e institucionit për të dëshmuar pëmbushjen e standardeve shtetërore në lidhje me kapacitetet dhe burimet njerëzore të duhura</i>

	<p><i>për mirëfunktionimin e departamentit (cf. CV-a e anëtarit më të ri nuk përfshihet në Evidencën 3.14 CV-të e pedagogëve NJBGJLQGR, ndërsa në website ende figuron si anëtare e departamentit të mëparshëm të saj, <a href="https://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/stafi-akademik/">https://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/stafi-akademik/</a>). Transferimi në fjalë plotëson standardin minimal ligjor për “të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë” (LAL Nr. 80 / 2015, Neni 25, Pika 4). Edhe asimetria e evidentuar në shpërndarjen e prodhimitarisë kërkimore-shkencore, siç do të tregohet më poshtë, nuk bind GVJ-në për konkluzionin e RVB-së. Nga ana tjetër, dinamika që u krijua gjatë dy viteve të fundit akademike, katër anëtarë të personelit akademik të departamentit u regjistruan nëpër programe doktorale prej të ardhmen, departamenti do të vijë drejt konsolidimit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Evidenca kyç për të kontrolluar këtë kriter është 2.7 “Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FESHSH”, ku programit të studimit i propozohet kodi “63BA9999X”. Kodi i propozuar është i gabuar, pasi në VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 “Për Specifikimin dhe Përbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit...” nuk ka fushë me kod 9999, ndërsa fusha 099 i përket fushës së shëndetit dhe mirëqënies, e cila nuk përkon me programin e studimit nën vlerësim. Nga ana tjetër, evidenca tjetër e cituar në RVB-në e lidhur me këtë, «Evidenca 2.14, Pasqyrimi i propozimeve për kodifikim e programeve», edhe pse i përket programit Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke, tregon për një orientim të departamentit drejt Mësuesisë. Nëqoftëse ky orientim përmbahet edhe në përcaktimin e kodit të saktësuar edhe te programi i studimit nën vlerësim, atëherë, fusha e përgjithshme (01 - Arsim) dhe ajo specifike (011 ose 018) e programit të studimit, sipas VKM Nr. 310, datë 11.05.2022, do të përputhet me fushën e njësisë bazë (Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore). Në qoftë se programi do të orientohet drejt gjuhëve të huaja (kodi 023) ose programeve ndërdisiplinore (028), atëherë, fusha specifike del përtej fushave specifike të njësisë kryesore. <b>Emërtesa e programit të studimit, Bachelor në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek”, duket më e përshtatshme për fushën 023 (Gjuhë të huaja). Në qoftë se programi i studimit orientohet drejt mësuesisë, në rishikimin e kurrikulave më të afërt do të duhej të shtohen, sipas standardeve në fuqi, ngarkesat mësimore në mësuesi, ose njësia kryesore të ndryshojë emërtesën për të përfshirë edhe fushën e gjuhëve të huaja ose asaj të shkencave humane.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ-ja gjykon se Kriteret 1-3 përmbushen plotësisht, ndërsa kriteret 4 dhe 5 jo plotësisht. GVJ-ja konstaton një përmirësim në kapacitetet e njësisë bazë organizuese të programit të studimit nën vlerësim, mirëpo ky është një dinamike e dy viteve të fundit që duhet kultivuar më tej. Për më tepër, në mungesë të dokumentacionit, dyshimi mbi përshtatshmërinë e programit të studimit në një Fakultet Edukimi nuk mund të sqarohet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



<b>Standardi I.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	RVB-ja ka paraqitur evidencë të bollshme dhe të mjaftueshme që dëshmojnë për sigurimin e marrëdhënies të frytshme bashkëpunimi për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit si brenda-përbrenda në njësi bazë (Evidenca 1.9. Rregullore e Brendshme e Njesisë Bazë; Evidenca 1.10. Rregullore e brendshme e programit Bachelor; Evidenca 1.33. Angazhim dhe ngarkesa mesimore vjetore 2022-2023; Aneks Tabela ASCAL 12.1-3), ashtu edhe ndërmjet departamenteve të tjera brenda Fakultetit (Evidenca 1.32. Njoftim i ngarkesës mesimore të Njësive të tjera në NJBGJLQGR). RVB-ja mandej evidenton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi në një aspekt më të gjerë drejtimi (Evid. 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Kreu II-V; Evidenca 2 Rregullore e brendshme e UGJ, kreu II-V).
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mesimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	<b>RVB-ja dhe vizita në institucion ka evidentuar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit (Evid. 1.12. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ; Evid. 1.13. Lista e projekteve të UGJ; dhe Evidenca 1.13.1. Lista e mobiliteteve të UGJ). Këto marrëdhënie janë të inkuadruara institucionalisht (Evid. 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej 2020-2025, ff. 31-32; Evidenca 1.25 Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UGJ-së) dhe departamenti luan një rol instrumental për ndërlidhjen e universitetit me IAL nga Greqia, si Universiteti i Janinës apo i Maqedonisë Perëndimore (Evidenca 1.24. Marrëveshje bashkëpunimit të UGJ).</b>  <i>E njëjta gjë nuk dëshmohet në raport me aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj, ku nuk pohohet se nuk ka asnjë bashkëpunim të tillë.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	<i>Sipas RVB-së dhe verifikimit në vizitë të GVJ-së, institucioni nuk ka marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, ose kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, praktikave të punës apo stazhit, pasi praktika të tilla nuk parashikohen në planin mesimor, përfshi edhe kurrikulën e programit të studimit nën vlerësim. Në diskutime me drejtimin e departamentit dhe fakultetit, justifikimi për mospasjen e marrëveshjeve të tilla ish-in kufizime ligjore dhe kapaciteteve të kufizuara të biznesit (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 1), arsye që cilësohen jobindëse sipas GVJ-së. Në takim me studentët, studentët cilësojnë se praktika mesimore do t'i ndihmonte në gjetjen e punës apo në krijimin e një</i>

	<p><i>rrjeti profesional (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 4). Mospasja e marrëveshjeve të kësaj natyre cilësohet si çështje për përmirësim nga GVJ-ja, sepse mungesa e tyre nuk ndihmon studentët të lidhen me tregun e punës, pedagogët të angazhojnë studentë në kërkimin shkencor në mënyrë institucionale dhe institucionin të vihen në kontakt me aktorët e fushës në raste të tilla si rishikimi i kurrikulave.</i></p> <p>Nga ana tjetër, në diskutime me pedagogët e programit të studimit nën vlerësim, u konstatua që, në mënyrë sporadike, pedagogët i caktojnë detyra studentëve që i shtyn të vihen në kontakt me aktorët e fushës.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB-së, Departamenti realizon vlerësime të tilla në kuadrin e raportit vjetor të tij (Evidenca 1.21.2. Raport mbi aktivitetin mësimor-kërkimor. Viti Akademik 2021-2022, f. 2; Evidenca 3.9 Raport Vjetor per Aktivitetin Shkencor te Dep. Viti Akademik 2018-2019; Evidenca 3.9.1 Raport Vjetor per veprimtarin shkencore NJBGJL dhe qyteterimit Grek 2021-2022). <i>Nga shqyrtimi i kujdesshëm i evidencave të mësipërme, RVB-ja konstaton se, pavarësisht aktiviteteve që raportohen dhe cilësimit, të drejtperdrejt apo jo, të tyre nuk rezulton ndonjë raport i mirëfilltë analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i> Nga ana tjetër, numri i mobiliteteve të kryera në sajë të këtyre bashkëpunimeve është dëshmi e përfitimeve, pavarësisht asimetrisë së tyre (midis pedagogëve, dhe pedagogëve dhe studentëve).</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kriteri 1 përmbushet plotësisht, në cilësimin e GVJ-së, ndërsa kriteret e tjera jo. Mungesa e praktikave mësimore dhe, rrjedhimisht, mospasja e marrëveshjeve të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e tyre cilësohet si sfidë për përmirësim në të ardhmën e afërt. Ndërkohë sugjerohet hartimi i një raporti vlerësues të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, me synim maksimizimin e përfitimeve të mundshme prej këtyre.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>																																																						
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>																																																						
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																																																					
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>RVB-ja raporton se programi i studimit nën vlerësim është organizuara në lëndë e module sipas kërkesave ligjore në fuqi (VKM Nr. 41 / 2018, i ndryshuar), ndërsa elementet përbërëse të strukturës së kurrikulës janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). <i>GVJ-ja bie kryesisht dakord me këtë cilësim, mirëpo, në ballafaqim me Evidencën 3.1 “Plan Mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek” dhe përpunimin statistikor sipas tabelës së mëposhtme, vëren si më poshtë:</i></p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <thead> <tr> <th></th> <th>Kat. A</th> <th>Kat. B</th> <th>Kat. C</th> <th>Kat. D</th> <th>Kat. E</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>v. I</td> <td>10</td> <td>32</td> <td>14</td> <td>4</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>v. II</td> <td>10</td> <td>35</td> <td>10</td> <td>5</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>v. III</td> <td>10</td> <td>17</td> <td>11</td> <td>12</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td></td> <td>30</td> <td>84</td> <td>35</td> <td>21</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td></td> <td>17%</td> <td></td> <td></td> <td>12%</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>50-55%</td> <td>12-15%</td> <td></td> <td>3-5%</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td colspan="2">63%</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Tre elemente të programit të studimit devijojnë nga baza e sipërcituar ligjore: Ngarkesat lëndore (në bazë të krediteve të tyre - ECTS) e kategorisë B (50-55%) rezultojnë poshtë përqindjes së parashikuar, ndërsa ato të kategorive C (12-15%) dhe E (3-5%) sipër normativës së caktuar. Për sa më sipër, GVJ-ja sugjeron që, në rishikimin më të parë të kurrikulave, të rishikohen ngarkesat respective për t'u përmbajtur plotësisht me legjislacionin në fuqi.</i></p>							Kat. A	Kat. B	Kat. C	Kat. D	Kat. E	v. I	10	32	14	4	0	v. II	10	35	10	5	0	v. III	10	17	11	12	10		30	84	35	21	10		17%			12%				50-55%	12-15%		3-5%			63%			
	Kat. A	Kat. B	Kat. C	Kat. D	Kat. E																																																	
v. I	10	32	14	4	0																																																	
v. II	10	35	10	5	0																																																	
v. III	10	17	11	12	10																																																	
	30	84	35	21	10																																																	
	17%			12%																																																		
		50-55%	12-15%		3-5%																																																	
		63%																																																				
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Qëllimi i programit të studimit është “një formim bazë në fushën e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar ... qoftë në aspektin e punësimit, qoftë edhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë...” (RVB, f. 15). Sipas RVB-së, “nëpërmjet veprimtarive formuese të parashikuara në planin mësimor studentët pajisen me njohuri bashkëkohore” gjuhësore, letrare dhe kulturore (Evidenca 3.1 Plan Mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek). <i>Për sa më sipër, edhe pse ndër qëllimet e programit të studimit është edhe formimi i studentëve në aspektin e punësimit, theksi asimetrik te njohuritë në kombinim me mungesën e praktikës duket sikur rezulton në dobësimin e synimit të zhvillimit të aftësive dhe sidomos të kompetencave profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e specializuar të studimit ose profesionale. GVJ-ja mirëkupton se mungesa e parashikimit të praktikës profesionale është vendim</i></p>																																																					

	<p>institucional me zbatim më të gjerë se programi i studimit nën vlerësim, por fton departamentin e programit të studimit të peshojë avantazhet e praktikës profesionale në mënyrë që mundësitë e punësimit me diplomë Bachelor të mos jenë të minimizuara.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit nën vlerësim i ka përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Kjo rezulton në planin e tij mësimor (Evidenca 3.1 Plan Mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek), i cili bazohet në rregulloren institucionale të studimeve (Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 23).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite përkundrejt detyrimeve përmbyllëse (Evidenca 3.1 Plan Mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek), <i>por “në planin mësimor të tij nuk përmban zhvillim të praktikës profesionale” (RVB, f. 16).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimit i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i studimit organizohet me kohë të plotë konform parashikimeve institucionale (Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 8, Pika 1.a). Rregullorja institucionale (Evid. 1.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nene 49, 61 dhe 65), e Fakultetit (Evidenca 1.5 Rregullore e Njësisë Kryesore FESHSH, Neni 16) dhe e programit të studimit (Evidenca 1.10. Rregullore e brendshme e programi Bachelor, Neni 9) përcaktojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve dhe janë konform parashikimeve ligjore në fuqi. Po ashtu edhe financimi i studentëve të ekselencës dhe të kategorive të veçanta (Evidencë 2.10 Vendim i BA për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; 2.11 Lista e studenteve me aftësi të kufizuara; 2.9.2 Vendim SA dhe Rektorati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Për sa i përket ngjashmërisë në nivelin e përmbajtjes së këtij programi studimi (Evidenca 3.1 Plan Mesimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek; Syllabuse 2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023), krahasimi me programet simotër të Universitetit të Tiranës dhe të Kolegjit Universitar LOGOS tregojnë për një ngjashmëri të konsiderueshme.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p><i>Në lidhje me kodifikimin e programit të studimit, shih komentet në Kriterin 5 (Kodi 9999), Standardi I.1. Më tej, asnjë lëndë nuk është e kodifikuar (shihni Evidenca 3.1 Plan Mesimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek; Syllabuse 2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023).</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit nuk është i përbashkët.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kriteret 3, 5 dhe 6 përmbushen plotësisht, sipas gjykimit të GVJ-së, ndërsa Kriteri Nr. 8 nuk ka lidhje me këtë program studimi, kështu del jashtë vlerësimit. Devijimi i elementeve të studimit nga baza</i></p>

	nënligjore, mungesa me vendim institucional i praktikave mësimore dhe profesionale, kodifikimi i gabuar i programit të studimit dhe mungesa e kodifikimit të lëndëve të programit të studimit moderojnë vlerësimin e kriterëve të tjerë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>RVB-ja (f. 18) raporton përmushjen e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin, <i>mirëpo evidencat e cituara aty (Evidenca 1.1.5. Vendimi i hapjes së ILP-së; Evidenca 1.29 Vendim KM për hapjen e Degës së Gjuhë_Letërsi Greke në UGJ) cilësohen të pamjaftueshme nga GVJ-ja.</i> Nga shqyrtimi i Rregullorës së Fakultetit (Evidenca 1.5 Rregullore e Njësisë kryesore FESHSH, Neni 5) rezulton se njësia kryesore përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><i>Në lidhje me stafin akademik të Departamentit organizues të programit të studimit nën vlerësim, u evidentua më sipër (Kriteri 4, Standardi 1.1) se kërkesat ligjore për numrin minimal të personelit akademik me grada dhe tituj u përmbushën vetëm pak javë para vizitës së GVJ-së (krhs. Evidencë 1_tabela 1 per personelin feshsh 2020-2023). Ngarkesat mësimore e personelit akademik janë të rënda (270-375 orë mësimore, sipas Evidencës 1.33. Angazhim dhe ngarkesa mesimore vjetore 2022-2023), përtej parashikimeve nënligjore jo vetëm për sa i përket ngarkesës normale mësimore jorrrallë duke tejkaluar edhe kufirin maksimal të përcaktuar në Kreun II, Pika 1 të Udhëzimit Nr. 29 / 2018 të ndryshuar të MASR-it (p.sh. pedagogu Nr. 2 me 360 orë, ose pedagogu Nr. 7 me 375 orë). Kjo ngarkesë, e shpërndarë në shumë lëndë (sipas Aneks-Tabelës 4, shumica e pedagogëve pa grada dhe tituj ka nga 4 dhe 5 lëndë) me orë suplementarë që, shpesh-herë, ishin të papaguara, sipas konstatimeve me pedagogët, zyrën e Financës dhe zyrën e Burimeve Njerëzore, në kombinim me kualifikimet e personelit akademik (shumica pa grade ose tituj), është dëshmi e nevojës së Departamentit në staf të kualifikuar akademik, mpresë që moderohet disi nga fakti që katër anëtarë të Departamentit janë tashmë në process doktorature.</i></p> <p><i>Për sa i përket vlerësimit, fakti që NjSBC-ja është në process zhvillimi (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 5) përbën dëshmi të mungesës së vlerësimit formal, së toku me faktin që vlerësimet nga të barabartit nuk praktikohen (op. cit., ff. 3-4). Dëshmi që kultura e vlerësimit është risi në këtë kontekst</i></p>

	<i>përbërn edhe fakti se ky është vlerësim për akreditim të parë dhe jo periodik, siç pritej nga një program studimi që operon për më shumë se 20 vjet.</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia kryesore raporton katër anëtarë të personelit ndihmës akademik për vitin akademik 2020-2021, tre anëtarë të personelit ndihmës akademik për vitin akademik 2021-2022 dhe po të njëjtin numër për vitin akademik 2022-2023 për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike, etj. (Evidenca 2_tabela 2 personel FESHSH_2023), por nuk specifikon cilët janë me karakter mësimor dhe cilët me karakter administrative, edhe pse kjo kategori e fundit del nga detyrat e disave (p.sh. sekretari mësimor). Edhe pse nuk deklarohet qartë, disa prej tyre shërbejnë edhe në programin e studimit nën vlerësim.			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në RVB-në raportohet se “kjo mënyrë organizimi u mënjanua” dhe, rrjedhimisht nuk ka koordinatort programi i studimit nën vlerësim. Gjatë intervistave në kuadrin e vizitës së GVJ-së rezultoi se <i>de facto</i> rolin e koordinatorit të programit të studimit e kishte marrë përsipër drejtuesi i departamentit. <b>Duke qenë se Departamenti ofron edhe një tjetër program studimi, GVJ-ja i sugjeron Departamentit të caktojë në të ardhmën nga një koordinatort për secilin program studimi në rastin e rritjes së studentëve në dy programet e studimit.</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Kriteret 2 dhe 3, në gjykimin e GVJ-së përmbushen plotësisht. Përkundrazi, Kriteri Nr. 1 ka paraqitur problematika të mëdha gjatë periudhës së vlerësimit dhe cilësohet si i përmbushur pjesërisht, edhe pse GVJ-ja ka konstatuar prirje të qarta përmirësimi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Si Fakulteti, ashtu edhe Departamenti përgjegjës i programit të studimit disponojnë informatat e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit të organizuara në dokumente të tilla, si Rregullorja e Departamentit ( <i>Evidenca 1.9. Rregullore e Brendshme e Njesise Baze</i> ); Rregullorja e programit të stumit ( <i>Evidenca 1. 10. Rregullore e brendshme e programi Bachelor</i> ); plani mësimor ( <i>Evidenca 3.1 Plan Mesimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek</i> ); dhe struktura mësimore ( <i>Evidenca 2.24 Struktura e vitit akademik Bachelor</i> ). Madje një pjesë e këtyre informative u komunikohen palëve të interesit edhe përmes mediave publike ( <a href="http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-gjuhesletersise-dhe-qteterimit-grek/">http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-gjuhesletersise-dhe-qteterimit-grek/</a> ). Takimi me studentët tregoi se edhe studentët, në vija të përgjithshme, kishin dijeni të këtyre informative (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek, f. 5).

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit përmban planin mësimor me gjithë informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit (Evidenca 3.1 Plan Mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek; Sylabuse 2020-2023). Madje një pjesë e këtyre informative është publikuar edhe te faqja zyrtare e departamentit (<a href="http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-gjuheslettersise-dhe-qyteterimit-grek/">http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-gjuheslettersise-dhe-qyteterimit-grek/</a>).</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ-ja konstatoi se programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ky informacion është i rregulluar në trajtë rregulloresh (Evid. 1.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nene 49, 61 dhe 65; Evidenca 3 Rregullore e studimeve në UGJ, Kreu VI; Evidenca 1.5 Rregullore e Njesise kryesore FESHSH, Kreu IV). Njëkohësisht, GVJ-ja u siguria se procedurat e parashikuara të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve praktikohen (Evidenca 2.3 Kriteret e pranimit 2021-2022 dhe 2.3.1 Kriteret e pranimit të studenteve 2022-2023).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ-ja vërtetoi pohimin e RVB-së që programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për seminarin, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara, pasio shqyrtoi planin mësimor (Evidenca 3.1 Plan Mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek) dhe silabët përkatës (Sylabuse 2020-2023).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>RVB-ja ka paraqitur evidencë të bollshme dhe të mjaftueshme se përmbajtja e programit të studimit rishikohet periodikisht dhe e gjithë procedura miratohet dhe arkivohet (p.sh. evidencë 2.4.2 Vendim SA për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019; 2.1 Vendim i SA për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022 dhe 2.1.1 Kthim përgjigje nga MAS). Arkivimi i këtij dokumentacionit ishte i rregullt, sipas verifikimeve në terren.</p> <p>GVJ-ja do të donte të shikonte evidencat e gjithëpërfshirjes së palëve të interesit në këtë proces (evidencat e dorëzuara janë nga niveli i drejtusit të departamentit e gjër në Senat), mirëpo në mungesë të tyre, ka një nivel përfshirjeje të pedagogëve (më pak të studentëve dhe aspark të aktorëve nga tregu i punës) gjatë vizitës në Institucion.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ-ja ka konkluduar se gjithë kriteret e këtij Standardi përmbushen plotësisht.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<b>Standardi II.4</b> <b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri I.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Përpos RVB-së, GVJ-ja ka shqyrtuar dhe analizuar programin e studimit (Evidenca 3.1 Plan Mesimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek) edhe plan programet lëndore (Sylabuse 2020-2023), për të dhënë një vlerësim të argumentuar. Emërtimi i programit përqëndrohet te tri fusha studimi të kombinuara: gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek. Orientimi i programit të studimit në shërbim të edukimit të minoriteti etnik grek të zones ka prodhuar domosdoshmërinë për disa lëndë të Pedagogjisë.</p> <p><b>1. Gjuha greke:</b> Në kurrikulë janë të dukshme sekuenca lëndësh që thellojnë gradualisht studentët në njohuri dhe aftësi të gjuhës (strukturim vertikal). Lëndët-bazë të morfologjisë, sintaksës, drejtshkrimit dhe historisë së gjuhës në v. I pasohen lëndë më të avancuara si leksikologjia dhe semantika në v. II dhe akoma më të avancuara si teoria dhe praktika e përkthimit (çuditërisht i cilësuar si lëndë bazë dhe jo karakterizuese) në v. III. Pozitiv është trajtimi i morfologjisë dhe sintaksës edhe në gjuhën shqipe, fakt që lejon qasje krahasuese gjuhësore, fort të përshatshme për studimin e gjuhës greke në Shqipëri. Studimi i gjuhës greke së toku me një gjuhë tjetër përkon edhe me praktikën ndërkombëtare të programeve të ngjashme (p.sh. pranë Universitetit të Oksfordit).</p> <p><b>2. Letërsia Greke:</b> <i>Lëndët e letërsisë kanë prirje më tepër horizontale se vertikale. Lëndët nëpër vite të studimit ndjekin një linjë kronologjike të letërsisë greke (Letërsi e re greke, shek. XI-XIV, v. II – Letërsi antike greke dhe Letërsia e re greke, shek. XVII-XIX, v. II – Letërsi e re greke, shek. XX dhe Letërsigreke, brezi i viteve '30 (me zgjedhje) në v. III. Teoria e Letërsisë (çuditërisht i cilësuar si lëndë integruese dhe jo karakterizuese) ofrohet në v. II dhe jo në v. III. Ky strukturim lejon zgjerimin e njohurive të studentëve, por jo domosdoshmërisht thellimin e njohurive dhe aftësive të tyre. Lënda “Teksti dhe analiza e tekstit letrar”, p.sh, mund të shërbente thellimin e dëshiruar, por ajo është parashikuar vetën si lëndë me zgjedhje dhe në v. I. Nga ana tjetër, lënda “Vështrim krahasues i letërsisë grekoshqiptare” përbën qartazi lëndë të avancuar që i shërben qëllimit të thellimit, edhe pse përgatitja paraprake e studentëve në letërsinë shqipe me një lëndë me zgjedhje “Letërsia e re shqipe” në v. II mund të ketë mangësi.</i></p> <p><b>3. Qytetërimi Grek:</b> Vihet re se asnjë nga lëndët e kësaj fushe, të ndryshme nga fushat e mësipërme, nuk është cilësuar si të Kategorisë B. Edhe këtu vihet re një prirje horizontale të strukturimit të njohurive dhe aftësive, pasi sekuenca e lëndëve nëpër vite nuk paraqitet të ketë përshkallëzim të thellimit (Historia e Greqisë në v. I – Arkeologjia dhe Kultura në Epir dhe Historia dhe Kultura Bizantine në v. II – Vështrim Diakronik i Kulturës Greke në v. III). Lënda e fundit, e cila, sipas emërtesës, mund t'i jepte</p>



	<p><i>kësaj fushe një qasje krahasuese diakronike strukturohet linearisht sipas kronologjisë. Nga krahasimi i silabëve, kjo lëndë ka mbivendosje të konsiderueshme me lëndën “Historia e Greqisë” të v. I.</i></p> <p><b>4. Pedagogjia:</b> Kjo fushë përfaqësohet nga një lëndë me zgjedhje të v. II (Mjedisi në Lëndët Shkollore të Arsimit Fillor), një tjetër lëndë me zgjedhje të v. III (Psikologjia dhe Pedagogjia në Shkollë) dhe një lëndë të detyrueshme po në v. III (Hyrja në Shkencat e Edukimit dhe Metodologjia e Edukimit). <i>Këtu vihet re që lënda hyrëse në shkencat e edukimit dhe në didaktikë të ofrohet në v. III, ndërsa lënda “Mjedisi në Lëndët Shkollore të Arsimit Fillor” që, për nga emërtesa (nuk është përfshirë programi lëndor i kësaj lende në evidencat) që thëllon mbi një çështje specifike parashikohet për në v. II.</i></p> <p><i>Në lidhje me aftësimin e studentëve për punësim është evidentuar më lartë si problematikë mungesa e praktikave mësimore.</i></p> <p><i>Për sa më sipër, GVJ-ja konkludoi se lypset një rishikim i kurrikulës së programit të studimit, në të cilin të merren parasysh edhe konstatimet e mësipërme.</i></p> <p>Nga ana tjetër, GVJ-ja pranon argumentin e RVB-së se pranimi i disa të diplomuarve në programin Master të këtij departamenti dhe gjetiu përbën dëshmi të mundësisit që programi i studimit u jep studentëve (Evidenca 2.21 Lista e aplikanteve fitues ne programin Master 2019-2020; 2.21.2 Lista emërore e aplikanteve fitues në AMU 2021-2022; dhe 2.21.3 Lista emërore e aplikanteve fitues në AMU 2022-2023).</p>																				
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ-ja shqyrtoi RVB-në, programin e studimit (Evidenca 3.1 Plan Mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek) edhe plan programet lëndore (Sylabuse 2020-2023), për të vlerësuar këtë kriter. GVJ-ja konkludoi se lëndët apo modulet, shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore përgjithësisht mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, por me vërejtjet e mësipërme.</p>																				
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit dhe lëndët janë deri diku në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Raporti teori-praktikë paraqitet jo i balancuar, siç do të tregojmë më poshtë (Kriteri 4).</p>																				
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Sipas Evidencës 4, 6_13 Tabela Ngarkesat e pedagogëve _20-21, raporti midis formimit teorik, aplikimit të teorisë dhe praktikës, të përfaqësuar nga leksione, seminare dhe praktika përkatësisht, paraqitet si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="555 1749 1362 1946"> <thead> <tr> <th></th> <th>Leksione (në orë)</th> <th>Seminare (në orë)</th> <th>Praktika (në orë)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>v. I</td> <td>412.5</td> <td>270</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>v. II</td> <td>450</td> <td>225</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>v. III</td> <td>427.5</td> <td>180</td> <td>45</td> </tr> <tr> <td></td> <td>1290</td> <td>675</td> <td>45</td> </tr> </tbody> </table>		Leksione (në orë)	Seminare (në orë)	Praktika (në orë)	v. I	412.5	270	0	v. II	450	225	0	v. III	427.5	180	45		1290	675	45
	Leksione (në orë)	Seminare (në orë)	Praktika (në orë)																		
v. I	412.5	270	0																		
v. II	450	225	0																		
v. III	427.5	180	45																		
	1290	675	45																		

	64%	34%	2%	
	<p><i>Nga sa më sipër, evidentohet një zotërim i leksioneve mbi seminarët dhe praktikën. Ky raport midis formimit teorik, aplikativ dhe praktik nuk cilësohet si i shëndosh nga GVJ-ja, pasi nuk i paraqitet t'i shërbejë aftësimin profesional të studentëve. Për më tepër, ky raport, i kombinuar me hapësirat që ofron Udhëzimi Nr. 29 / 07.10.2022 i MAS-it "Për Frekuentimin e Procesit Mësimor" dhe evidencat e mbledhura gjatë vizitës dhe evidencat e tjera të dorëzuara në dokumentacionin shtesë të institucionit (Evidencë shtesë - kampion i vlerësimit me notë) mbi raportimin e notave, duket sikur nuk kurajon frekuentimin e rregullt e lëndëve nga të gjithë studentët, siç paraqitet nga numri tepër i lartë i studentëve që nuk u paraqiten në provimet e rregullta. Mungesa e regjistrave të mungesave, që ose asgjeshohen në fund të çdo semestri ose mbeten në kopmjuerat e pedagogëve nuk e bëri të mundur të merret parasysh edhe numri i mungesave nga seminarët.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i silabëve (Sylabuse 2020-2023) rezulton se përditësimi i tyre gjatë tre viteve të fundit ka ndodhur më shumë kur një lëndë ofrohet nga një pedagog tjetër (p.sh. Lënda "Hryje në Shkencat e Edukimit..."), ndërsa silabët kanë prirje të ngurta përditësimi, kur lënda ofrohet nga i njëjti pedagog (p.sh. lënda "Stilistika e Tekstit"). Literatura e përdorur është nga mjaft deri shumë e vjetëruar dhe ky konkluzion merr parasysh se disa libra në fushën e studimeve humane mbeten klasike edhe shumë kohë pas shkrimit të tyre. Gjithashtu, paraqitja e leksioneve të përgatitura nga pedagogët në literaturë bazë të detyrueshme nuk rekomandohet nga GVJ-ja. Lypset një rishikim tërësor në mundësinë më të parë.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit (Sylabuse 2020-2023) përgjithësisht garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, por gjithmonë me vërejtjet e mësipërme.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Në lidhje me aftësimin e studentëve për punësim është evidentuar më lartë si problematikë mungesa e praktikave mësimore. Nga ana tjetër, GVJ-ja pranon argumentin e RVB-së se pranimi i disa të diplomuarve në programin Master të këtij departamenti dhe gjetiu përbën dëshmi të mundësimit që programi i studimit u jep studentëve (Evidenca 2.21 Lista e aplikanteve fitues në programin Master 2019-2020; 2.21.2 Lista emërore e aplikanteve fitues në AMU 2021-2022; dhe 2.21.3 Lista emërore e aplikanteve fitues në AMU 2022-2023).</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ-ja mendon se Kriteret 2 dhe 3 përmbushen plotësisht, Kriteret 1, 6 dhe 7 përmbushen kryesisht, ndërsa Kriteret 4 dhe 5 përmbushen pjesërisht. Prandaj GVJ-ja rekomandon një rishikim tërësor të kurrikulës.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<b>Standardi II.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>RVB-ja pretendon se angazhimi "i personelit të Departamentit të Gjuhës, Letërsisë, dhe Qytetërimit Grek në modulet e trajnimit në kuadër të projektit" Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një system gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri" (RVB, ff. 23-24) shërben në analizimin e nevojave të studentëve të diplomuar. Evidencat e cituara (Evidenca 2.5 Memorandum IAL dhe MAS per TEAVET; 2.5.1 Teavet), nga ana tjetër, nuk përmendin as cilët anëtarë të departamentit morën pjesë si trajnues, cilët student të diplomuar morën pjesë dhe si ky angazhim është përfshirë në procesin e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit dhe të përshtatjes sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. RVB-ja, njëkohësisht, pretendon se përfshirja e anëtarëve të Departamentit, në bashkëpunim me instance të tjera të Departamentit në aktivitete promovuese të programit të studimit ndihmon, po ashtu në këtë proces. <i>Këta argumente nuk paraqiten bindëse, sipas gjyqimit të GVJ-së, pasi në RVB-në nuk ka evidencat e mirëfillta mbi procedurën e rishikimit të kurrikulave dhe rolin e aktorëve të ndryshëm në të.</i> Nga ana tjetër, GVJ-ja pranon se "eksperiencat, njohuritë dhe aftësitë e përfituara nëpërmjet trajnimeve dhe pjesëmarrjeve në projekte të personelit akademik të" Departamentit "synojnë në përmirësimin e përmbajtjes dhe ecurisë së programeve të studimit që ofrohen" (RVJ, f. 24, duke referuar te Evidencat 2.27 Përfshirja në planet mësimore e materialeve në kuadër të projektit Te Comp), mirëpo, nuk ka parë as nga evidencat as nga vizita në institucion konkretisht si këto përvoja janë marrë parasysh në procesin e rishikimit të kurrikulës së këtij programi studimi. <i>Për sa më sipër, GVJ-ja qëndron në sugjerimin e tij se lypset një rishikim tërësor i kurrikulës, gjatë procedurës së të cilës duhen konsultuar edhe institucionet partnere, edhe të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës, sidomos këta të fundit, ndërsa e gjithë procedura duhen dokumentuar me detaje.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>RVJ-ja pretendon se përmbush këtë kriter pa dhënë evidencat (i referohet pjesëmarrjes së studentëve në Senat, por nuk jep asnjë evidencë mbi përfshirjen e studentëve në vendimmarrjen e Departamentit, pavarësisht përfshirjes së një studenti në GVB-në), ndërsa as gjatë vizitave në institucion nuk dolën të dhëna konkrete në lidhje me këtë. <i>Rrjedhimisht, GVJ-ja sugjeron që në procesin e radhës të rishikimit të kurrikulës të konsultohen edhe studentët edhe të diplomuar, ndërsa sugjerohet që të realizohen periodikisht edhe takime të departamentit me studentët dhe të mbahen process-verbale.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje</p>	<p>RVB-ja pretendon përmbushjen e këtij kriteri duke u mbështetur në një vendim për përfshirjen e një lënde (Hartim dhe Menaxhim</p>

<p>me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Projekti) me zgjedhje në v. III, si rrjedhojë të bashkëpunimit të institucionit në një projekt (RVJ, f. 24, duke referuar te Evidencat 2.27 Përfshirja në planet mësimore e materialeve në kuadër të projektit Te Comp). Evidencat e tjera të cituara (Evidenca 1.24, Marrëveshje bashkëpunimit të UGJ) nuk shtojnë të dhëna konkrete. Evidenca e përdorur nga RVB-ja është e bazuar, sipas GVJ-së, edhe pse reflekton një proces nga kokë-poshtë pa dëshmuar rolin e departamentit në procesin e vendimmarrjes. <i>Mungesa e praktikave mësimore dhe, rrjedhimisht, mungesa e marrëveshjeve me aktorë të tregut të punës të evidentuar më sipër përbëjnë disavantazh për programin e studimit, sepse e izolon nga një rrjet profesionistësh, i cili mund të konsultohet në kuadrin e përmirësimit, përditësimit dhe përshtatjes së programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ-ja mendon se ka hapësirë të bollshme për përmirësim në këtë standard dhe cilëson se kriteret e tij përmbushen kryesisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Për të dhënë një vlerësim të argumentuar, GVJ-ja, përpos RVB-së, ka shqyrtuar programin e studimit (Evidenca 3.1 Plan Mesimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek) edhe plan programet lëndore (Sylabuse 2020-2023). Nga analizimi i këtyre evidencave rezulton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit/ esetë, projektet dhe orët e hapura, por nuk ka praktika mësimore. Këto forma rezultojnë të miratuara në rregullorët (Evidenca 1.5 Rregullore e Njesise kryesore FESHSH, Neni 26/1; Evidenca 1.10. Rregullore e brendshme e programi Bachelor, Neni 25, f. 9; Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 22; Evidenca 1.9. Rregullore e Brendshme e Njesise Baze, Neni 17).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	RVB-ja argumenton si kombinimi i përvojës shumëvjeçare të pedagogëve të programit të studimit me numrin e vogël të studentëve në programin e studimit nën vlerësim u lejon pedagogëve të përdorin metoda alternative të mësimdhënies dhe të nxënit. Mandej, RVJ-ja raporton se pedagogët janë të trajnuar për metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit dhe se ka edhe udhëzues përkatës për qëndrueshmërinë e dijës (Evidenca 3.11 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të mësimdhënies dhe Evidenca 3.11.1 Vendim SA për miratimin e udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative). GVJ-ja ka vërtetuar zbatimin e sa më sipër gjatë intervistave me studentët (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, ff. 4-5). Institucionit u kërkua nga GVJ-ja një evidencë shtesë për të dëshmuar një rast konkret zbatimin të sa më sipër. Evidenca e dorëzuar nga institucioni (Evidencë shtesë - komunikim student - pedagog) vërtetojnë zbatimin e disa metodave, përpos komunikimit të hapur dhe të mirë midis studentëve dhe pedagogëve.  <i>GVJ-ja shpresonte të shikonte se si ky kriter praktikohet në shërbim të studentëve me status të veçantë pas informatave të RVB-së (f. 26). Me keqardhje GVJ-ja vuri re se studenti në fjalë nuk i vazhdoi studimet në UGJ.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Shtjellimi i këtij kriteri në RVB-në dhe argumentet e përdorura janë bindëse. Përpos trajnimit dhe manualit të përmendur më lartë (Evidenca 3.11 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të mësimdhënies dhe Evidenca 3.11.1 Vendim SA për miratimin e udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative), GVB-ja argumenton se mbështetja institucionale e personelit akademik në drejtim të përmirësimit të kompetencave didaktike dhe

	<p>të përputhjes me rezultatet e pritshme të të nxëniet paraqitet edhe në forma të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i ambienteve të përshtatshme (Evidenca 4.10 Infrastruktura e UGJ).</li> <li>• Pajisma me mjete kompjuterike (Evidenca 4.7 Inventari i DGJLQG).</li> <li>• Mobilitetet jashtë vendit (Evidenca 1.13.1. Lista e mobiliteteve të UGJ).</li> <li>• Mundësia e përdorimit të bazave elektronike të të dhënave (si JSTOR, U-Library, shif Evidenca 4.8.6 dhe 2.18), <i>statistika për përdorimin e të cilave nuk ishin të disponueshme as nga departamenti dhe as nga biblioteka, pas verifikimit në terren.</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Për sa i përket metodave të mësimdhënies interaktive, shihni Kriterin Nr. 2, më sipër, ku ka edhe konkluzionet e GVJ-së për marrëdhëniet e respektit të ndërsjellë midis pedagogëve të programit të studimit nën vlerësim dhe studentëve të tij.</p> <p><i>Aty ku GVJ-ja nuk është e bindur në nivelin e pretenduar nga RVB-ja është te ekspertiza e personelit akademik, ose një pjesë të tij të paktën, për të ofruar një numër shumë të madh lëndësh. U evidentua më sipër (shihni Standardin II.2, Kriteri 1), se pjesa më e madhe e personelit akademik, nuk është me grada dhe tituj (krhs. Aneks-Tabela Nr. 6.1-6.3, Cilësia e Stafit Mësimdhënës) dhe se pikërisht kjo pjesë është e mbingarkuar në orë mësimi në një numër të madh lëndësh mjaft heterogjenë (krhs. Aneks-Tabela Nr. 4, Ngarkesa Totale e Personelit Akademik). P.sh., një pedagogu pa titull akademik (dhe gradë), sipas kësaj tabele, u është caktuar të japë mësimet në pesë lëndë, ndër të cilët Historinë e Greqisë, Stilistikën e Tekstit dhe Strukturat Tradicionale Shoqërore, që i përkasin lëmëve të Historisë, Gjuhësisë dhe Sociologjisë përkatësisht. Studimet e pedagogut (Evidenca 3.14, CV-të e pedagogëve) nuk dëshmojnë ekspertizë në asnjë nga të tria disiplinat, ndërsa edhe veprimtaria kërkimore-shkencore përqendrohet kryesisht te leximi në kontekstin e mësimdhënies së gjuhës. Ky rast nuk është unik dhe rrjedhimisht, GVJ-ja nuk është i bindur se i gjithë personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është njëjtrajtshëmrisht kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të çdonjërit prej disiplinave lëndët e së cilës i kërkohet të japin. Nga ana tjetër, GVJ-ja, siç u raportua më sipër, konstatoi një dinamikë positive gjatë dy viteve të fundit akademike, pasi katër anëtarë të personelit akademik të departamentit u regjistruan nëpër programe doktorale gje që premtan se brenda në një periudhë të arsyeshme departamenti do të vijë drejt konsolidimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p>	<p>Vlerësimi i formave e metodave të mësimdhënies me synim përmirësimin kryhet kryesisht nëpërmjet komenteve të studentëve (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, ff. 4-5 dhe Evidencë shtesë - komunikim student - pedagog).</p>

<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p><i>Duke qenë se NjSBC-ja e institucionit qe në formim gjatë vizitës (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 5), edhe pse përbërja e saj dhe rregullorja është e miratuar që nga viti 2020 (Evidenca 6.1 Rregullore e NJSBC dhe Evidenca 6.9 Vendim i SA për ngritjen e NJSBC), GVJ-ja konstatoi që, pavarësisht që, në mungesë të një zyre NjSBC të ngritur, anketimi sistematik i studentëve me instrumentin e miratuar (6.7 Urdhër për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ) duke ishte i realizuar në këtë program studimi, vetë departamenti e ka ndër të nevojshme një vlerësim të tillë, ka zhvilluar një pyetësor dhe e ka administruar atë me disa studentë për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies (Evidenca 6.3 Pyetësorët e NJBGJLQG).</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>RVB-ja raporton se në rang institucioni operon Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-Akademike (DSHNA, Evid. 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 42). Njësia është funksionale (Evidenca 3.3 për Rregullorën e saj; krhs. Evidenca 6.12 Raport i pyetësorit dhe përcjellja në Fakultete-1) dhe, sipas RVB-së, dy sektorë që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies: 1. Sektorin e Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave; 2. dhe Sektorin e Kërkimi Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, i cili ka kontribuar në pjesëmarrjen e institucionit në disa projekte me objekt përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies (Evid. 1.13. Lista e projekteve të UGJ; krhs. 3.13, 3.13.1-4).</p> <p><i>Edhe pse raportohet (RVB-ja, f. 28) se në UGJ funksionon NjSBC (Evidenca 6.1 Rregullore e NJSBC dhe Evidenca 6.9 Vendim i SA për ngritjen e NJSBC), e cila rol një rol në përmbushjen e këtij kriteri, kjo zyrë ishte në zhvillim gjatë vizitës (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 5).</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ-ja konkludoi se Kriteret 1-3 përmbushen plotësisht ose pothuajse plotësisht. Kriteret 5 dhe 6 përmbushen kryesisht, ndërsa Kriteri Nr. 4 përmbushej pjesërisht, por me prirje të qarta përmirësimi fal procesit të përmirësimit të kualifikimeve të anëtarëve të Departamentit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi III.2</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e</p>	<p>RVB-ja ka treguar në mënyrë bindëse edhe se kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të ndryshme, edhe se këto bëhen publike dhe njihen nga studentët. Si dëshmi citon, më të tjerash, Rregullorën</p>

<p>programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme. bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>institucionale të Studimeve (Kreu V), Rregullorën e Departamentit (Kreu IV, Neni 18) dhe Rregullorën e Studimit (Kreu V, Nene 27-32). Gjatë bashkëbisedimit me studentët e programit, GVJ-ja verifikoi deklaratën e RVB-së që ato “u bëhen publike studentëve në fillimin e studimeve në UGJ edhe në vazhdim...” (krhs. Evidenca 5.27 Udhërefyjes për studentet). Departamenti afishon informata përkatëse edhe në faqen e vetë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>RVB-ja raporton se studentët njihen me metodat e vlerësimit e tyre që nga fillimi i lëndës nëpërmjet plan programeve lëndore të tyre (Sylabuse 2020-2023) dhe studentët e konfirmuan atë (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 5).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Baza rregullative e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore lejon realizimin e tyre në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentëve të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara (Evidenca 3 Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 39; Aneks-Tabela Nr. 15; Evidenca 1.5 Rregullore e Njesise kryesore FESHSH, Neni 32), siç pohon edhe RVB-ja.</p> <p><i>Nga një anë më kritike, pesha 80% që i akordohet provimit përfundimtar (krhs. Sylabuse 2020-2023), sipas GVJ-së, disi shfuqizon format e tjera të testimit dhe vlerësimit të parashikuara. Prandaj, sugjeron rishikim institucional të sistemit të vlerësimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i formave e metodave të mësimdhënies me synim përmirësimin kryhet kryesisht nëpërmjet komenteve të studentëve (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, ff. 4-5 dhe Evidencë shtesë - komunikim student - pedagog).</p> <p><i>Duke qenë se NjBSBC-ja e institucionit që në formim gjatë vizitës (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 5), edhe pse përbërja e saj dhe rregullorja është e miratuar që nga viti 2020 (Evidenca 6.1 Rregullore e NJSBC dhe Evidenca 6.9 Vendim i SA për ngritjen e NJSBC), GVJ-ja konstatoi që, pavarësisht që, në mungesë të një zyre NJSBC të ngritur, ankëtimi sistematik i studentëve me instrumentin e miratuar (6.7 Urdhër për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ) duke ishte i realizuar në këtë program studimi, vetë departamenti e ka ndërjerë të nevojshme një vlerësim të tillë, ka zhvilluar një pyetësor dhe e ka administruar atë me disa studentë për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies (Evidenca 6.3 Pyetësorët e NJBGJLQG).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike. të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit. objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies</p>	<p>RVB-ja raporton se në rang institucioni operon Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-Akademike (DSHNA, Evid. 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 42). Njësia është funksionale (Evidenca 3.3 për Rregullorën e saj; krhs. Evidenca 6.12 Raport i pyetësorit dhe përcjellja në Fakultete-1) dhe, sipas RVB-së, dy sektorë që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së</p>



<p>inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>mësimdhënies: <b>1.</b> Sektorin e Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave; <b>2.</b> dhe Sektorin e Kërkimi Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, i cili ka kontribuar në pjesëmarrjen e institucionit në disa projekte me objekt përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies (Evid. 1.13. Lista e projekteve të UGJ; krhs. 3.13, 3.13.1-4). <i>Edhe pse raportohet (RVB-ja, f. 28) se në UGJ funksionon NJSBC (Evidenca 6.1 Rregullore e NJSBC dhe Evidenca 6.9 Vendim i SA per ngritjen e NJSBC), e cila rol një rol në përmbushjen e këtij kriteri, kjo zyrë ishte në zhvillim gjatë vizitës (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 5).</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se kriteret 1-2 përmbushen plotësisht, ndërsa kriteret e tjerë përmbushen kryesisht për mendimin e GVJ-së.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi III.3</b> <b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet përgjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar (Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 39; Aneks-Tabela Nr. 15; Evidenca 1.5 Rregullore e Njesise kryesore FESHSH, Neni 32). Siç u paratha, vlerësimi i vazhduar me aktivitete që zënë jo më shumë se 20% e notes përfundimtare, disi shfuqizojnë synimin e vetë vlerësimit të vazhduar.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>RVB-ja deklaron se “në institucion nuk aplikohen sisteme elektronike testimi dhe vlerësimi”, pasi “përdoren metodat tradicionale të kontrollit të dijeve dhe vlerësimit” (RVB, f. 33). GVJ-ja ka pyetur pedagogët dhe studentët për sistemet e kontrollimit të origjinalitetit. Pedagogët pretenduan se temat që i caktonin studentëve ishin specifike që përjashtonin mundësitë e formave të ndryshme të abuzimit (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 4), përgjigje që nuk u cilësua bindëse, edhe për arsye të mungesës së evidencave. Drejtuesi i departamentit përshkroi një mënyrë që aplikon vetë, që kombinon instiktin e tij me kërkime në platoformën Google për evidentimin e burimeve pjesave të plagjarizuara. Studentët ishin të familjarizuar me termin plagjaturë (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 5). <i>GVJ-ja i sugjeron Departamentit organizimin e një seminari trajnimi nga vetë drejtuesi i departamentit duke ndarë metodën që praktikon.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar është pa dyshim konform bazës ligjore (Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 39; Evid. 1.2</p>

	Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 90). Vlerësimi përfundimtar i studentit rezulton si shumë e vlerësimit të vazhduar në masën 20% dhe vlerësimi në provim në masën 80% (Aneks-Tabela Nr. 14; Syllabuset 2020-2023). <i>Mungesa e evidencave nga testimet e studentëve dhe e listave të detajuara të notave me gjithë komponentet e tyre shtyn GVJ-në të sugjerojë që provimet dhe procesverbalet e detajuara të testeve dhe provimeve të arkivohen pranë departamentit për një cikël riakreditimi.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	RVB-ja sugjeron se vlerësimi i vazhduar dhe përfundimtar shoqërohet me komente dhe këshilla mbi procesin e të nxënit. Citon bazën rregullative (Evid. 1.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 90) dhe përshkruan procedurën dhe planin kohor të lëshimit të notave (Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 46). Mungesa e testeve ose detyrave të kursit nga arkivi i departamentit nuk lejoi verifikimin e këtij raporti. Nga ana tjetër, evidencat shtesë të kërkuara përfshijnë edhe një korespondencë midis një pedagogu dhe një studente që nuk përfaqëson një vlerësim përfundimtar, por vlerësimin dhe komentimin e një komponenti të zhvillimit të një detyre kursi, aty ku ka më tepër kohë dhe hapësirë për përmirësim (Evidencë shtesë - komunikim student - pedagog).
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	RVB-ja argumenton se plagjiatura shmanget ose nuk lejohet nga njësia përgjegjëse duke cituar Kodin e Etikës (Evidenca 3.5 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Nenet 25 dhe 26). RVB-ja ndalet edhe te kultura e origjinalitetit që promovon departamenti dhe konsultimet me pedagogët që bëhen gjatë zhvillimit të punimeve (krhs. Evidencë shtesë - komunikim student - pedagog). <i>GVJ-ja i qëndron rekomdimit të vlerësimi i Kriterit 3, më sipër, dhe i sugjeron institucionit të abonohet në databaza të tilla të kontrollimit të origjinalitetit, si TURNITIN.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Afatet kohore dhe parashikime për vlerësim në bazë merite parashikohen në rregulloret (Evid. 1.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 90 dhe Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 46). Mungesa e fletave të provimeve nuk ndihmon për një përgjigje sa më të bazuar, por, tezat e provimeve (Evidenca 3.4.2 Forma të ndryshme Tezash Provimi) janë të karahasueshme për nga niveli i veshtorisë me programe të ngjashme të studimit dhe përftojnë përgjigje kritike, të informuara prej dijeve të grumbulluara. Provimet, sipas RVB-së realizohen me sekretim, element që promovon vlerësimin e bazuar në merita.
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin. kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	RVB-ja përshruan procedurën dhe afatet e parashikuara, duke i bazuar edhe te rregulloret (Evid. 1.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 88, 90; Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 45-46; Evidenca 1.5 Rregullore e Njesise kryesore FESHSH, Neni 35). Studentët raportuan se afatet zbatohen, ndërsa komunikimi është i vazhdueshëm dhe brenda hapësirave kohore të parashikuara (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 5).
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i	Pedagogët dhe studentët raportuan se nuk ka patur raste ankimesh, sepse çdo paqartësi sqarohet në mënyrë rezultative që nga faza e

vlerësimi dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira. dokumentohet dhe arkivohet.	konsultimit të studentit me pedagogun për notën (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, ff. 3-5).			
<b>Konkluzione</b>	GVJ-ja është e mendimit se standardi përmbushet pothuajse plotësisht, pasi Kriteret 1, 4, 6, 7 dhe 8 përmbushen plotësisht, ndërsa 2, 3 dhe 5 kryesisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive. të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Thellimi i njohurive dhe zhvillimi i aftësive profesionale dhe të veçanta i studentëve parashikohet në Rregullorën e Programit të Studimit (Evidenca 1.10. Rregullore e brendshme e programi Bachelor, Neni 6). Për zbatimin e këtij parashikimi, shih komentet e GVJ-së të Kriteri 1, Standardi II.4.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit parashikon një zhvillim të balancuar të aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (Evidenca 1.10. Rregullore e brendshme e programi Bachelor, Neni 6). Elementet e mësipërme dallohen edhe në mënyrë të shpërndarë nëpër lëndë të ndryshme, edhe nëpërmjet lëndëve të posaçme, si “Teknologji të reja në komunikim” (Evidenca 3.1, Plani Mësimor). Vizita në institucion ka treguar se ka një bazë të mjadfueshme laboratorike për t’i shërbyer këtij qëllimi. RVB-ja, për më tepër, argumenton se mësimi i gjuhës së huaj ndihmon, sui vegël komunikimi, në zhvillimin e aftësive të tilla.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti. të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde. analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblylëse.	Raporti i RVB-së në shtjellimin e këtij kriteri i referohet përmbledhjes që realizohet në përfundim të një lënde, element që nënkupton një proces më tepër individual i analizimit e shqyrtimit të kompetencave dhe aftësive që fitojnë studentët edhe vlerësimi të vazhduar (Evid. 1.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 19; Evidenca 1.10. Rregullore e brendshme e programi Bachelor). Në takimin me pedagogët u përmend se vlerësimet të tilla diskutohen edhe në asambltë e departamentit (Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë – Letërsi e Qytetërim Grek - UGJ), edhe pse GVJ-së nuk u janë paraqitur proces-verbalet përkatëse.
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të	Në mendimin e RVB-së, programi përziën formim teorik me përvoja praktike. Edhe pse termi ‘kompetenca’ rrallë përdoret nëpër silabët lëndore (Syllabuse 2020-2023), GVJ-ja i bashkohet këtij mendimi, pasi reflektoi mbi silabët e paraqitur. Kompetenca të transferueshme zhvillohen edhe përmes (bashkë)punimeve në grup(e), si element që praktikohet në disa lëndë. Në krijimin e një klime të mirë, Departamenti i angazhon studentët në mini-projekte kërkimore dhe i shtyn të marrin pjesë në aktivitetet publike të tij (Evidenca 3.10 Plani

<p>caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>i veprimtarive akademike, shkencore-kulturore 2021-2022; krhs. Minutat e takimeve Bachelor në Gjuhë, Letërsi e Qytetërim Grek – UGJ, f. 5), me raste edhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë. Departamenti krijon edhe mundësi të konsiderueshme mobiliteti për studentët (Evid. 1.12. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ), pavarësisht se sfrytëzohen pak ose aspak nga studentët e programit të studimit nën vlerësim.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bashkëpunimet institucionale të sipërcituara sfrytëzohen edhe për organizimin e orëve të hapura me pedagogë të ftuar nga IAL-të partnerë (Evidenca 3.13 Ftesë për leksione të hapura dhe pjesëmarrje në aktivitete pedagogjike të GJLQGREK). Departamenti, ndërkohë, është partner kryesor i organizimit të seminareve kualifikuesve të mësuesve të gjuhës greke (Evidenca 3.13.1 Organizim seminaresh me Univ.Janines 17.11.17; Evidenca 3.13.2 Organizimi i seminareve ne bashkëpunim me Universitetin e Janines; Evidenca 3.13.3 Info dhe bashkëpunim ne lidhje me organizimin e seminareve, ne Universitetin e Maqedonise Perendimore-Greqi dhe Evidenca 3.13.4 Seminar 6 - mujor për metodat e mësimdhënies). Intervistat me studentet dhe personelin akademik i treguan GVJ-së se personeli akademik krijon kushte dhe klimë kurajuese për zhvillimin e ideve inovative të studentëve</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ-ja mendon se Standardi III.4 përmbushet deri diku plotësisht, edhe pse konstaton se NjSBC-ja është ende në zhvillim, ndërsa i sugjeron institucionit krijimin e një qendre për mësimdhënien dhe të nxënit në nivel institucional me synim rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. Kjo qendër mund të funksiononte edhe nën tagrën e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardëve të Cilësisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p><b>Standardi III.5</b> <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Edhe pse në RVB pranohet se "nuk ka një rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës" GVJ-ja është dakord me konkluzionin se parashkimet në rregullore të ndryshme (Evidenca Evid. 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 93; Rregullore e studimeve ne UGJ, Nene 59-64; Evidenca 1.5 Rregullore e Njësisë kryesore FESHSH, Nene 39-42 dhe Evidenca 1.10. Rregullore e brendshme e programit Bachelor, Neni 26) përbëjnë zvendësues. Në harmoni me politikën e Fakultetit, Departamenti kas vendosur prapun 8.0 e notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome, politikë e cila është e</p>

	publikuar (Evidenca 1. 10. Rregullore e brendshme e programi Bachelor, Neni 26).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Personeli akademik dhe strukturat drejtuese të programit të studimit asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse të publikuara në rregullorët (Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 61; Evidenca 1.10. Rregullore e brendshme e programi Bachelor, Neni 26) dhe sidomos në doraçakun e punimit të diplomës (Evidenca 3.7.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve). Drejtuesi i temës përcaktohet me vendim departamenti dhe mbështetja që i ofron studentit të mbikqyrur është përgjithësisht e mjaftueshme, siç u konfirmua edhe nga njëra prej studentëve të intervistuar.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Rregullat e mësipërme parashikojnë se, kur, në vend të mbrojtjes së diplomës realizohet provim i përgjithshëm përfundimtar, komisioni i posaçëm, i përbërë nga 3-5 anëtarë të personelit akademik të departamentit të fushave që mbulon programi i studimit (Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 62 dhe 64). Sipas RVB-së, provimi është gjithëpërfshirës dhe programi i tij miratohet nga drejtuesi i Departamentit dhe ng Dekani i Fakultetit (Evidenca 3.7.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve). Hartimi i tezës së provimit (Evidenca 3.4.3 Tezë e provimit përfundimtar) siguron mbulimin e të gjithë fushave të studimit.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t' u paraqitur para komisionit.	Procedura e përzgjedhjes së udhëheqësit të diplomës parashikohet te Neni 61 i Rregullorës së Studimeve (Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ). RVB-ja nuk ofron evidenca konkrete dhe Evidenca 3.7.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve nuk përbën dëshmi të kushteve konkrete të mbikqyrjes. Megjithatë, pedagogët përshkruan mënyrës e mbikqyrjes gjatë vizitës në institucion.
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ-ja nuk e kishte të mundur ta verifikonte me evidenca konkrete (citimi i Nenit 38 i Rregullorës së programit të studimit nga ana e GVB-së nuk përbën dëshmi të praktikimit të parashikimeve. As studentët e intervistuar nuk kishin dijeni, njëra ishte në procesin e përzgjedhjes së temës, ndërsa tjetra ende nuk ishte në këtë fazë, rrjedhimisht deklaratat e tyre se parashikimet zbatohen ishin “me të dëgjuar.” Edhe pse jo i paraqitur si dëshmi për punimin e tezave të diplomave, Evidenca 3.10 “Plani i veprimtarive akademike, shkencore-kulturore 2021-2022” mund të cilësohet si tregues të

	interesit të Departamentit t'i përfshijë studentët në aktivitete kërkimore.			
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi i provimit përfundimtar të formimit dhe i punimit të diplomës bëhet me notë, siç u konstatua edhe gjatë vizitës pranë sekretarisë mësimore.			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe shtojcë të saj (Evidenca 1.5 Rregullore e Njesise kryesore FESHSH, Neni 41). Modelet e këtyre janë bashkëngjitur RVB-së për evidence (2.6 Model, Diploma Bachelor dhe 2.6.1 Supplement Diplome 1).			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Ruajtja e dokumentacionit të studentit dhe përdorshmëria e dokumentacionit të arkivuar u gjetën konform parashikimeve ligjore dhe statutore dhe rregullative të institucionit (Evidenca 1.5 Rregullore e Njesise kryesore FESHSH, Neni 46; Evidenca 3 Rregullore e studimeve ne UGJ, Nene 70-74). Dokumentacioni ruhet pranë sekretarisë mësimore, e cila ndjek rregullat përkatëse të Rregullorës së saj (Evidenca 5.30 Rregullore e Sekretarise mesimore, Nene 7-9).			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ-së i është paraqitur evidencë e mjaftueshme për të konkluduar se Standardi III.5 përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë shënon një prodhimtari kënaqshëm kërkimore-shkencor, siç është dokumentuar në CV-të e tyre.</p> <p><i>Megjithatë, për të avancuar akoma më tej nivelin e kontributit të tyre, kërkohet një përpjekje sistematike drejt publikimit të artikujve në revista të indeksuara dhe të renditura në bazë të kriterëve si Clarivate Analytics (ish-Thomson/Reuters), SCOPUS, apo libra/kapituj të botuar në shtëpi botuese të renditura në SENSE Academic Publishers. Ky angazhim për të përfshirë veprimtarinë kërkimore në forume prestigjioze ndërkombëtare do të thellojë reputacionin shkencor të personelit akademik dhe do të rrisë prezantueshmërinë e institucionit. Është e rëndësishme të zhvillohet një strategji afatgjatë për përmirësimin e cilësisë së publikimeve shkencore, duke adresuar veçanërisht mundësitë për të kontribuar në mjedise të njohura dhe të pranuar ndërkombëtare shkencore.</i></p> <p>Referuar Tabelave nr. 2 (2/1 dhe 2/2) në Anex Tabelat Përmbledhëse rezultojnë se për:</p> <p>Vitin akademik 2020 -2021 Personeli Akademik Efektiv (PAE) paraqitet, në vijim:1 Prof. Asoc., 2 Dr., 5 Msc. – ndërsa Personeli Akademik me Kontratë (PAK) rezultojnë, si vijon: 1 Msc.</p> <p>Vitin akademik 2021 -2022 Personeli Akademik Efektiv (PAE) paraqitet, në vijim:1 Prof. Asoc., 1 Dr., 6 Msc. – ndërsa Personeli Akademik me Kontratë (PAK) rezultojnë me 0.</p> <p>Vitin akademik 2021 -2022 Personeli Akademik Efektiv (PAE) paraqitet, në vijim:1 Prof. Asoc., 1 Dr., 3 Msc. (Dr. në proces), 3. Msc. – ndërsa Personeli Akademik me Kontratë (PAK) rezultojnë me 0.</p> <p><i>Bazuar në tabelat përmbledhëse Anex nr. 2/2 dhe 2/2, vihet re se në vitet akademike 2021-2022 dhe 2022-2023 stafi i Departamentit nuk është plotësuar me tituj/grada në përputhje me kërkesat ligjore. Ndërsa në vitin akademik 2023-2024, Departamenti i plotëson keto kërkesa (3 tituj/grada).</i></p> <p><i>Le për të dëshiruar kualifikimi i stafit Akademik, por gjithsesi në vitin akademik 2022-2023 janë 3 Dr në proces.Kjo mund të konsiderohet një tendencë pozitive.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Për më tepër, struktura e programit të studimit është e përcaktuar me qartësi dhe transparencë, duke grupuar lëndët dhe modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe duke caktuar ngarkesën përkatëse në kredite. Ky organizim transparent i veprimtarive formuese shihet në planin</p>

	<p>mësimor të programit, siç vërtetohet nga Evidenca 3.1 dhe Evidenca 3.</p> <p>Planifikimi i programit të studimit përfshin një plan mësimor me informacion të detajuar lidhur me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve dhe moduleve, si dhe orët e caktuara për mësim në auditorium dhe jashtë tij (Evidenca 3.1 Syllabuse 2020-2023). Pjesë e kësaj informative është bërë publike në faqen zyrtare të departamentit (<a href="http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-gjuheslettersise-dhe-qyteterimit-grek/">http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-gjuheslettersise-dhe-qyteterimit-grek/</a>). Ky nivel i transparencës dhe aksesit të informacionit ndihmon në kuptimin e plotë të strukturës dhe organizimit të programit nga studentët dhe personeli akademik, duke kontribuar në lehtësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimi.</p> <p><i>Bazuar në takimet që u bënë gjatë vizitës në institucion gjithë ngarkesa mësimore (100%) mbulohej nga stafi akademik me kohë të plotë. Në takimet me stafin akademik u tha që një pjesë e ngarkesës mbulohej në baza vullnetare. Zyra e Burimeve Njerëzore kishte shpallur vende vakante disa herë, por nuk ishin paraqitur kandidatë. Kjo u konfirmua edhe nga Përfaqësuesja e Zyrës së Burimeve Njerëzore.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të paraqitura dhe takimeve të kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UGJ ka një eksperiencë shumë të mirë në punësimin e një stafi cilësor me dëshirë për t'u kualifikuar, dhe që demonstroi qëndrueshmëri në vite. GVJ konstaton se gjatë tre viteve të fundit akademike, të shqyrtuara për akreditim, personelin akademik i angazhuar në këtë program studimi është zgjeruar, dhe në përgjithësi stafi nuk ka ndryshuar, një përqindje shumë e lartë e stafit akademik efektiv të angazhuar gjatë vitit 2020-2021 ka vazhduar të angazhohet edhe në dy vitet e ardhshme akademike. (Tabelat Përmbledhëse Anex ASCAL; Evidenca 4.6. Procedura e punësimit të stafit akademik).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedurën e rekrutimit dhe vlerësimin, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedura e rekrutimit të personelit zhvillohet në përputhje me legjislacionin e përshtatshëm të UGJ. Për të siguruar një proces transparent dhe të drejtë, kriteret specifike përcaktohen me kujdes, dhe përpjekjet janë të ndërruara gjatë gjithë procesit të rekrutimit për të gjetur një kandidat sa më afër nevojave të Departamentit. Prioritet i jepet nivelit të studimeve, përshtatjes së interesave shkencore të kandidatit me lëndën, përvojës akademike të mëparshme dhe punës shkencore, siç vërtetohet në Evidencat 2.8, 4.26 dhe 4.5.</p> <p><i>Një tregues pozitiv është regjistrimi i katër anëtarëve të personelit akademik në programe doktorale, një zhvillim që paralajmëron për konsolidim të mëtejshëm të departamentit në të ardhmen.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas</p>	<p>Institucioni nuk ka dokumentuar angazhimin e personelit ndihmës mësimor për orë laboratorike, dhe ky fakt shpjegohet nga mungesa e nevojës për mbështetje nga stafi laboratorik ndihmës. Arsyeja kryesore e kësaj mungese është se natyra specifike e programit studimor nuk ka kërkuar nevojën e një personeli të posaçëm për mbështetje laboratorike.</p>



natyrës specifike të programit të studimit.	
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh. ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtar në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Institucioni, përmes Sektorit të shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari-protokolli, si pjesë e Drejtorisë së shërbimeve ndihmës-akademike administrative (si strukturë përgjegjëse), mbledh, ruan dhe përditëson rregullisht të dhënat për çdo anëtar të personelit akademik që përfshihet në realizimin e programin të studimit, si dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit (Evidenca 3.3 & Evidenca 4.1). Sektori i kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë, gjithashtu mbledh, ruan dhe përditëson rregullisht të dhënat mbi kërkimin shkencor të personelit akademik, pjesë e Departamentit (Evidenca 3.3). Departamenti ruan dhe përditëson rregullisht (çdo vit akademik) dokumentet përkatëse si dhe (ngarkesën mësimore) për çdo semestër dhe vit akademik për secilin anëtar të personelit të përfshirë në programin e studimit (Evidenca 1.5 & Evidenca 1.9 & Evidenca 4.2 dhe 4.3)
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsie dhe Qytetërim Grek" nuk përfshin zhvillimin e praktikës profesionale në planin e tij mësimor. Plani mësimor dhe Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsie dhe Qytetërim Grek" ofrojnë një shpjegim të qartë të detyrimeve përfundimtare. Sipas Rregullores së UGJ-së dhe informacioneve nga (Evidenca 1.2), (Evidenca 1.5), (Evidenca 1.10), dhe Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Letërsie dhe Qytetërim Grek (Neni 11, nën-pikat a dhe b), studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor diplomohen përmes një provimi të përgjithshëm përfundimtar ose një punimi diplome, përfaqësuar me 10 kredite.
<b>Kriteri 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Sipas Raportit, në aplikimin fillestar për programin Bachelor, ishte përcaktuar një koordinator, megjithatë, në vijim ky vendim u ndryshua. Është vërejtur se nuk ka evidencë të disponueshme as për zgjedhjen e parë të koordinators dhe as për arsyen e këtij ndryshimi në strukturën organizative. Rekomandohet dokumentimi dhe ruajtja e evidencave për të pasiguarur një mbikëqyrje dhe llogaridhënie më të mirë në strukturat organizative të programit.
<b>Konkluzione</b>	<i>Pas një vlerësimi të thelluar, mund të konkludojmë se personeli akademik tregon një prodhimtari të kënaqshëm kërkimor-shkencor, por për të avancuar duhet të kujdeset për publikimin në revista prestigjioze ndërkombëtare. Programi i studimit shquhet për organizimin dhe transparencën, duke siguruar një mjedis efektiv mësimor. Procedurat e rekrutimit janë në përputhje me legjislacionin, por duhet të rritet dokumentacioni për zgjedhjen e koordinators dhe ndryshimet në strukturë. Në të njëjtën kohë, detyrimet përfundimtare të programit Bachelor janë të përcaktuara qartë, edhe pse nuk përfshihet zhvillimi i praktikës profesionale.</i>

	<i>Për të avancuar më tej, institucioni duhet të kujdeset për dokumentim më të mirë dhe të krijojë një strategji afatgjatë për përmirësimin e cilësisë së publikimeve shkencore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" zhvillohet në Godinat A dhe B të UGJ-së, të cilat janë vlerësuar si të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të nevojshme. UGJ përbëhet nga godinat A, B dhe C dhe ka një gjendje shumë të mirë, duke i përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara, përfshirë standardet higjieno-sanitare (evidenca 4.10.1) dhe standardet teknike (Evidenca 4.10.2 & 4.10.3).
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Departamenti disponon kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të mjaftueshme për të akomoduar studentët dhe personelin akademik. Mjediset mësimore që shërbejnë këtij programi studimi, përfshirë auditorë leksionesh, seminare dhe laboratorë, janë të gjerë dhe plotësuese për nevojat e studentëve të këtij programi. Këto mjedise janë të pajisura me teknologji moderne, që sigurojnë realizimin e procesit mësimor, si në aspektin teorik ashtu edhe praktik. Laboratorët e kompjuterëve ofrojnë çdo student një kompjuter elektronik me programe / software dhe gjithashtu me burime të hapura, siç është dëshmuar nga vizita e GVJ në institucion dhe nga evidencat 4.7.  <i>Megjithatë, për të siguruar cilësinë dhe vazhdimësinë e këtij nivelit të cilësisë, rekomandohet që mjediset mësimore të këtij programi studimi të përfshijnë auditorë me kushte të përshtatshme, laboratorë për lëndët laboratorike të përkthimit, dhe laboratorë të kompjuterëve. Kërkojmë që çdo student të ketë në dispozicion një kompjuter elektronik me programe / software komerciale, por edhe me burime të hapura, qasje në internet, memorie përkthimi dhe mjete të tjera përkthimi, si dhe një larmi burimesh elektronike.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të	Mjediset mësimore që shërbejnë për këtë program studimi, duke përfshirë auditorë leksionesh, seminare dhe laboratorë, janë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për të plotësuar kërkesat e moduleve, aftësitë teorike dhe praktike, si dhe objektivat formuese të programit të studimit në përgjithësi. Këto mjedise përfshijnë kompjuterë, projektorë, dhe pajisje të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e procesit mësimor.

42

objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në të njëjtën kohë, pajisja e auditorëve me lidhje WiFi (pa pagesë) në të gjitha mjediset e UGJ-së kontribuon në zhvillimin e mësimdhënies interaktive, duke përdorur metodologjitë e teknologjive bashkëkohore. Kjo mundëson një akses të lehtë në bazat e të dhënave greke dhe të huaja që janë lidhur me programin e studimit, siç është dëshmuar nga evidenca 4.7 dhe vizita e GVJ në institucion.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni thekson se, për shkak të natyrës së tij, nuk ka laboratorë të disponueshëm, por ka arritur të përmbushë nevojat për laboratorë duke përdorur mjediset e përshtatshme të UGJ-së. Me qëllim që të sigurohet një përdorim efektiv dhe për të plotësuar kërkesat për laboratorë, rekomandohet të zhvillohen një bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me UGJ-në. Është po ashtu e rëndësishme të kryhen hapa konkretë për të siguruar që mjediset e Universitetit ose UGJ-së përdoren optimalisht dhe për të plotësuar nevojat e institucionit për laboratorë.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" zhvillohet në godinat A dhe B të UGJ-së, të cilat janë vlerësuar si të mjaftueshme për nevojat e aktiviteteve mësimore. UGJ ka një gjendje shumë të mirë dhe përmbush kushtet e kërkuara, duke përfshirë standardet higjieno-sanitare dhe teknike. Departamenti ofron mjediset mësimore me kapacitet infrastrukturor dhe teknologji moderne për të akomoduar studentët dhe personelin akademik. Laboratorët e kompjuterëve janë të pajisur me aparatura dhe mjete të nevojshme. Për të siguruar cilësinë dhe vazhdimësinë e këtij nivelit, rekomandohet një bashkëpunim i ngushtë me UGJ-në dhe veprime konkrete për përdorimin efektiv të mjediseve dhe plotësimin e nevojave për laboratorë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimdhënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme. të parashikuara në programin e studimit.	Biblioteka e NJB dhe UGJ-se ofron një gamë të gjerë të literaturës multidisiplinare nga shumë fusha të studimit, duke përfshirë gjuhën, letërsinë, shkencat shoqërore, ekonominë, shkencat e natyrës, historinë, artin, dhe më shumë. Kjo përfshin një koleksion të pasur për programin e studimit, duke përfshirë vepra për antikitetin greko-romak, periudhën bizantine, letërsinë moderne greke, folklorin, dhe autorët e MEG, siç edhe paraqitet nga evidenca 4.8.1. Për të pasuruar këtë koleksion, sugjerohet hartimi dhe miratimi i një plani disa-vjeçar për zhvillimin dhe pasurimin e bibliotekës, duke i akorduar fonde konkrete për implementimin e tij.

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Biblioteka e institucionit ka ngritur një sistem të strukturuar të raportimit dhe monitorimit të cilësisë së fondit të saj, duke përfshirë atë fizik dhe online. Raportet e saj, si Tabelat 17 dhe Evidencat 4.23, 4.24, 4.25, dhe 4.8.5, ofrojnë informacion të detajuar mbi përdorimin dhe shfrytëzimin e fondit nga personeli akademik dhe studentet. Megjithatë ka një kërkesë për literature të fundit të pesë viteve, GVJ-ja konstatoi se shpesh lënda përdor literature klasike të periudhave me të hershme. Gjithashtu, konstatimi rreth numrit të ulët të librave ndihmës në gjuhën greke dhe disa kopjeve të të njëjtave tituj tregojnë nevojën për përpjekje të plotë në pasurimin dhe diversifikimin e koleksionit bibliotekar.</p> <p>Për të adresuar këtë sfidë, rekomandojmë hartimin dhe miratimin e një plani disa-vjeçar për zhvillimin dhe pasurimin e bibliotekës, duke përfshirë akordimin e fondeve konkrete për implementimin e këtij plani. Kjo do të sigurojë që biblioteka të jetë në gjendje të përgjigjet nevojave të përdoruesve dhe të ofrojë një burim të pasur dhe të aktualizuar të njohurive.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ofron dy biblioteka, Bibliotekën Nr. 1 (Bibliotekën e Institucionit) dhe Bibliotekën Nr. 2 (Bibliotekën e Departamentit), si burime të disponueshme për studentët e programit të studimit. Sipas tabelave përmbledhëse, tabela 17, studentët kanë të drejtë të anëtarësohen në këto biblioteka dhe të përdorin literaturën, si fizike ashtu edhe atë elektronike. Për këtë qëllim, secili student disponon një kartelë personale të përdoruesit, përmes së cilës mund të marrë dhe kthejë materialet e nevojshme. (Bazuar në Vizitën e GVJ në Institucion.)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Vizitën e GVJ në Institucion dhe Evidencën 4.8.1, Biblioteka e NJB dhe ajo e UGJ-së ofrojnë një gamë të gjerë të literature me qasje multidisiplinare për studentët. Përmbanin tituj nga fusha të ndryshme studimi, duke përfshirë gjuhën, letërsinë, shkencat shoqërore, ekonominë, shkencat e natyrës, artin, historinë, gjeografinë, dhe shumë fusha të tjera.</p> <p><i>Megjithatë, është rëndësishme të theksohet se përmbledhja nuk përfshin titujt e viteve të fundit, dhe informacioni mbi aktualizimin e koleksioneve mund të jetë i pamjaftueshëm.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka ndërmarrë hapa për të siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në bibliotekat online që lidhen me fushën e programit të studimit, siç tregohet në Evidencën 4.8.4. Te gjithë studentët kanë mundësi të përdorin librarinë dixhitale për nevojat e tyre studimore, siç është evidentuar gjatë Vizitës së GVJ në Institucion. Megjithatë, është theksuar se biblioteka nuk është e pajisur me aksesore dhe teknologji asistuese për studentët me aftësi të kufizuara.</p>
	<p><i>Sugjerimi është që në kuadrin e strategjisë për gjithë përfshirjen, të zhvillohet, buxhetohet dhe implementohet një plan për pajisjen e bibliotekës me teknologji asistuese, duke përfshirë aksesore dhe pajisje të tjera që mund të përmirësojnë përvojën e studentëve me</i></p>

	<i>paafësi ose aftësi të kufizuara. Kjo do të siguronte një mjedis të barabartë dhe të përshtatshëm për të gjithë studentët, duke adresuar nevojat specifike të përdoruesve me paafësi.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike. që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga Vizita e GVJ në Institucion u konstatua se biblioteka është e pajisur me disa kompjuterë të cilët ofrojnë studentëve mundësi të aksesojnë dhe përdorin kompjuterët për shkrimin e punimeve të tyre, duke shfrytëzuar njëkohësisht edhe burimet e literaturës online përmes motorëve të kërkimit. Ky vendim ofron një shërbim shtesë për studentët, duke i ndihmuar ata në përgatitjen e punimeve të tyre me përdorimin e burimeve të larmishme online.
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ofron shërbim nga punonjësit e saj për studentët dhe personelin akademik gjatë ditëve të javës, nga e hëna deri të premten (me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit), në orarin 8:00—19:00.  Kjo kohë përshtatet me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përballohet me numrin e studentëve dhe kapacitetin e saj. Orari është i afishuar në mjediset e institucionit dhe në hyrjen e Bibliotekës. Për çdo student, është e mundur të disponojë një kartelë personale të përdoruesit për të përdorur shërbimet e bibliotekës, siç konfirmon Evidenca 4.8.
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë mbi cilësinë e fondit fizik dhe online, duke përfshirë titujt kryesorë në shërbim të programit studimor. Përmbledhja përfshin aspektet e përditësimit, shkallën e shfrytëzimit nga personeli akademik dhe studentët, përdorimin e sallave të studimit, dhe përpjekjet për pasurim të fondit fizik dhe online. Tabelat 17 dhe Evidencat 4.23, 4.24, 4.25, 4.8.5 sigurojnë një analizë të detajuar të këtyre elementeve.
<b>Konkluzione</b>	<i>Biblioteka e NJB dhe UGJ-se ofron një gamë të gjerë të literaturës multidisiplinare, duke përfshirë gjuhën, letërsinë, shkencat shoqërore, ekonominë, shkencat e natyrës, historinë, artin, dhe më shumë. Kjo përfshin një koleksion të pasur për programin e studimit, duke përfshirë vepra për antikitetin greko-romak, periudhën bizantine, letërsinë moderne greke, folklorin, dhe autorët e MEG. Institucioni monitoron cilësinë dhe përdorimin e fondit fizik dhe online nga personeli akademik dhe studentët, siç deshmojnë tabelat 17 dhe Evidencat 4.23, 4.24, 4.25, dhe 4.8.5. Ka një përpjekje për siguruar akses të barabartë në bibliotekat online për studentët e programit, megjithatë, nevojitet përmirësim i aksesit dhe pajisjeve për studentët me aftësi të kufizuara. Nga vizita e GVJ në institucion, konstatohet se biblioteka ofron disa kompjuterë për studentët dhe është e hapur nga e hëna deri të premten, 8:00—19:00.</i>

	<i>Rekomandimet për përmirësime përfshijnë shtimin e teknologjive asistuese, përmirësimin e aksesit dhe hartimin e një plani disa-vjeçar për zhvillimin dhe pasurimin e koleksionit bibliotekar.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Bazuar në informacionin e prezantuar, organizimi administrativ në UGJ nuk parashikon një sekretari të veçantë për çdo njësi bazë apo program studimi, por ka një sekretari të përgjithshëm dhe sekretari të fakulteteve. Institucioni mban regjistra të rregullt me të dhëna specifike mbi regjistrimin e studentëve, numrat e matrikullimit, dhe informacione tjera, duke filluar nga dita e regjistrimit deri në diplomim. Ky proces i dokumentimit është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, siç përcakton Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, siç është evidentuar nga Vizita në institucion dhe Evidenca 1.1 dhe 5.30.</p> <p>Në këtë kuadër, në UGJ ka funksionuar një sistem elektronik i automatizimit të proceseve të sekretarisë mësimore dhe shërbimeve online për studentët me funksionalitetet e caktuara në Rregulloren e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar ESSE3, sipas Evidencës 4.15. Ky hibrid i proceseve manuale dhe sistemit elektronik tregon përpjekjen e institucionit për të përdorur teknologjinë për efikasitetin dhe shërbimin më të mirë ndaj studentëve.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Bazuar në Evidencat 3.3, 4.1 dhe dosjet e personelit nga Vizita e GVJ në institucion, dokumentacioni lidhur me aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, nga momenti i tyre rekrutimi deri në vazhdimësinë e angazhimeve, menaxhohet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-Akademike &amp; Administrative. Kjo drejtori kujdeset për administratën dhe arkivimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme. Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretarisë Protokoll në kuadër të kësaj drejtorie ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin e dokumentacionit. Dosjet personale përmbajnë informacione të tilla si kontratat e punës, diplomatë dhe tituj akademikë, CV-të dhe të dhëna të tjera relevante për arritjet akademiko-shkencore të personelit. Kjo përfshin një përjasje efektive dhe të rregullt të dokumentacionit që lidhet me profilin dhe kontributin e secilit anëtar të personelit në institucion.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të	

46

<p>gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e ofruar nga Vizita e GVJ në institucion, i gjithë dokumentacioni i Institucionit është i qasshëm nga personeli akademik dhe studentët në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Te interesuarit që dëshirojnë të marrin informacionin e nevojshëm duhet të drejtohen tek zyra përkatëse për këtë qëllim.</p> <p>Informacioni mund të kërkohet dhe marrë përmes drejtpërdrejtësisë së faqes zyrtare të institucionit, sipas adresës <a href="https://uogj.edu.al/">https://uogj.edu.al/</a> Ky hap ka për qëllim të sigurojë transparencë dhe qasje të lirë ndaj dokumentacionit për të gjithë personelin akademik dhe studentët sipas ligjit mbi të drejtën e informimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në Evidencat 3.2.5 dhe 3.2.6, personeli akademik dhe studentët të UGJ përdorin përveç faqes zyrtare dhe postës elektronike edhe disa platforma elektronike të tjera. Këto përfshijnë Microsoft Office 365, Microsoft Teams, LearningKey, dhe platforma të tjera. Në faqen zyrtare të institucionit [<a href="https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/">https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/</a>] përmbahen informacione rreth përdorimit të platformave të tilla si Office 365 dhe Teams për mësimin online. Kjo tregon se Institucioni ka integruar mjete dhe resurse moderne teknologjike për të mundësuar mësimin online, bashkëpunimin, dhe komunikimin efikas midis personelit akademik dhe studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Platformat elektronike si ESSE3, Pitagora, Microsoft Office 365, Microsoft Teams, dhe LearningKey sigurojnë një monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Sipas nevojave, këto sisteme ofrojnë mundësi për raportime individuale në lidhje me përparimin akademik të studentëve dhe afatet e vendosjes së vlerësimeve nga personeli akademik.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë. ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Njësia bazë e UGJ-së ka një faqe interneti dhe një faqe në Facebook për të informuar studentët, ish-studentët dhe komunitetin për veprimtarinë e saj. Informacioni i publikuar në faqen zyrtare të UGJ-së dhe Departamentit përfshin detaje rreth programit të studimit, misionit, planit mësimor, strukturës mësimore, orarit, dhe kalendari i provimeve. Gjithashtu, shpallet informacion mbi Njësinë Bazë, personelin akademik, dhe aktivitete të ndryshme në gjuhën shqipe dhe angleze. (Evidenca 1.1)</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UGJ ka një organizim administrativ me një sekretar të përgjithshëm dhe një sekretar për fakultetet, duke përdorur një sistem regjistrimi të përbashkët për studentët, duke integruar proceset manuale me një sistem elektronik (Evidenca 4.15). Dokumentacioni i personelit administrativ dhe akademik menaxhohet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-Akademike &amp; Administrative (Evidencat 3.3, 4.1). Dokumentacioni i institucionit është i qasshëm për personelin akademik dhe studentët, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit (Vizita e GVJ në institucion).</i></p> <p><i>Përdorimi i platformave elektronike si ESSE3, Pitagora, Microsoft Office 365, Microsoft Teams, dhe LearningKey siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ (Evidencat</i></p>

47

	<p>3.2.5 dhe 3.2.6). Njësia Bazë ka një faqe interneti dhe një faqe në Facebook për komunikim të ndryshëm me studentët dhe komunitetin, duke ofruar informacion në gjuhën shqipe dhe angleze, përfshirë detaje mbi programin e studimit, misionin, planin mësimor, orarin, kalendari i provimeve, si dhe informacion mbi personelin akademik (Evidenca 1.1).</p> <p>Megjithatë, rekomandohet përmirësimi i sistemit elektronik për të rritur efikasitetin dhe përshtatshmërinë. Në veçanti, kujdesi për sigurimin e një përdorimi optimal të bibliotekës digjitale dhe përshtatja e platformave elektronike për të mbështetur raportimet individuale dhe monitorimin në kohë reale do të përmirësonte përvojën e përdoruesve.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në informacionin e prezantuar, UGJ zhvillon një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbajtjen e programeve të studimit. Hartimi i këtij raporti ndodh në përputhje me Statutin e UGJ dhe modelin e buxhetit të shtetit, të caktuar nga udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Administratori i UGJ harton projektin e buxhetit vjetor, duke u bazuar në propozimet e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë, të mbështetura në Planin Strategjik të zhvillimit të UGJ-së dhe Planin buxhetor afatmesëm. Ky projekt buxheti miratohet nga Bordi i Administrimit, me propozim të Senatit Akademik. (Evidenca 1.1, 4.9, 1.3, 4.20)
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Ky proces është pjesë e strukturave qendrore të menaxhimit financiar të UGJ-së dhe njësive bazë, duke përfshirë edhe NJBGJLQG. Këto struktura kontribuojnë përmes propozimeve dhe kërkesave për veprimtari, projekte, botime, pjesëmarrje në kongrese, pasurim të bibliotekës, abonime, dhe aktivitete të tjera që nuk janë pjesë e drejtpërdrejtë e mbulimit financiar të procesit akademik në auditor. Propozimet dhe kërkesat e tyre dërgohen në përputhje me përcaktimet ligjore, nevojat, dhe planet strategjike të zhvillimit të institucionit. Miratimi i kërkesave përcaktohet në buxhetin e finalizuar, duke pasqyruar nevojat dhe interesat e institucionit. (Evidenca 4.16, 4.17, 4.18, ANEKS-Tabela 18)



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij në mënyrë periodike. Drejtoria e Shërbimeve Universitare harton dhe paraqet Raportin Financiar Vjetor, duke përmbledhur të ardhurat dhe shpenzimet sipas kërkesave ligjore në fuqi. Ky raport ofron një pasqyrë të detajuar të situatës financiare të institucionit. Përmasat financiare të UGJ janë nën vëzhgimin e institucioneve përgjegjëse, duke përfshirë Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe MAS (Ministria e Arsimit dhe Sportit), të cilat kryejnë audit financiar periodik për të siguruar transparentë dhe rregullsi në administratën e financave publike. (Evidenca 4.16, 4.17, 4.18, 4.19, 4.21, 4.22)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas praktikës në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe Administratori paraqesin raporte periodike në Senatit dhe Bordin e Administrimit, raportuar për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraprak.</p> <p>Ky proces siguron një transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin financiar, duke siguruar që organet vendimmarrëse të institucionit të kenë një vështrim të qartë mbi shpenzimet dhe të ardhurat aktuale. [Evidenca 4.16, 4.17, 4.18, 4.19, 4.21, 4.22]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë sigurohet financiarisht nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat dytësore nga studentët, duke përfshirë tarifën e regjistrimit, tarifën e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet e tjera ofruara ndaj të tretave.</p> <p>Analiza financiare vjetore e institucionit fokusohet në menaxhimin e efikas të këtyre burimeve për të garantuar një qëndrueshmëri financiare. Për këtë qëllim, vlerësohet realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare dhe të gjitha aspektet e financimit dhe shpenzimeve, duke siguruar që fondeve të disponueshme t'u jepet një përdorim të përshtatshëm. [Evidenca 4.16, 4.17, 4.18, Tabela 18]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në informacionin paraqitur, UGJ ndjek një procedurë transparente për hartimin dhe zbatimin e buxhetit. Administratori i UGJ harton projektin e buxhetit vjetor, duke përfshirë propozimet e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë, në përputhje me Planin Strategjik të zhvillimit të institucionit.</i></p> <p><i>Ky projekt miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik (Evidenca 1.1, 4.9, 1.3, 4.20). Gjithashtu, raportimi financiar i UGJ përfshin një analizë të kostove dhe mbështetjes financiare për programet e studimit, duke u fokusuar në një qëndrueshmëri financiare.</i></p> <p><i>Strukturat e menaxhimit financiar, përfshirë NJBGJLQG, prezantojnë propozime dhe kërkesa për veprimtari dhe projekte që kontribuojnë në pasurimin e institucionit (Evidenca 4.16, 4.17, 4.18, ANEKS-Tabela 18).</i></p> <p><i>Rekomandoj rritjen e përpjekjeve për komunikim të qartë dhe transparent në lidhje me përdorimin e fondeve, përfshirjen e një segmenti të posaçëm për informim publik në faqen zyrtare për të</i></p>

	<i>ndihmuar në ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e komunitetit institucional dhe publikut në përgjithësi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Pranimi i studentëve të rinj dhe procesi i tyre akademik në kuadër të ciklit të plotë në UGJ është ndërtuar mbi një politikë të qartë, e hartuar dhe zbatuar me respekt për kornizën ligjore aktuale dhe rregullat vendore të institucionit. Kjo politikë dhe dispozitat korrespondojnë me Statutin dhe rregulloren e UGJ, siç paraqitet në Evidencat 1.1, 1.2, 1.5 dhe 1.9. Procesi fillon me përcaktimin e kuotave dhe kriterëve nga Njësitë Baze, duke u nisur me një vendim të Senatit Akademik një vit para fillimit të vitit akademik të ardhshëm, siç shpjegohet në Evidencat 5.4, 5.7, 2.3.1, 5.8, dhe 5.18.1. NJBGJLQGR, duke respektuar kriteret e institucionit dhe duke u bazuar në nevojat dhe karakteristikat e veta, përcakton kuotat dhe kriteret e veta identifikuese, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të UGJ: <a href="https://uogi.cdu.al">https://uogi.cdu.al</a> , siç konfirmohet në Evidencën 5.3.5.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat dhe dispozitat ligjore të UGJ-së dhe NJBGJLQGR-së për trajtimin e studentëve, nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve, kanë si synim sigurimin e barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit në programin e studimit. Ky angazhim përbën dokumentacionin aktual, praktikat aktuale, dhe përvojën afatshkurtër dhe afatgjatë, të cilat nuk kanë treguar raste të provuara të diskriminimit apo shkeljes së barazisë. Statuti i UGJ-së (Evidenca 1.1) dhe Rregullorja e Studimeve në UGJ (Evidenca 1.4), së bashku me dokumentacionin analog të njësisë tjera, detajojnë me kujdes procedurat dhe praktikat për trajtimin e studentëve, duke siguruar transparencë dhe trajtim të drejtë për të gjithë. Informacioni për kandidatët është i aksesueshëm në Mjetet e Komunikimit Publik të UGJ-së dhe në portalin U-Albania, duke përfshirë kriteret dhe kuotat e pranimit [ <a href="https://uogi.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/Statutin%20e%20Universitetit">https://uogi.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/Statutin e Universitetit</a> ] [ <a href="https://uogi.edu.al/statuti-i-universitetit/">https://uogi.edu.al/statuti-i-universitetit/</a> ], dhe Rregullore e Universitetit [ <a href="https://uogi.edu.al/rregullore-e-universitetit/">https://uogi.edu.al/rregullore-e-universitetit/</a> ].
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Institucioni aplikon një proces transparent për pranimin e studentëve, duke publikuar kriteret dhe kuotat në faqen zyrtare para fillimit të vitit akademik. Këto kriteret janë në përputhje me VKM-të aktuale dhe aprovohen nga Dekanati dhe Senati Akademik. Strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve të ardhshëm, duke përfshirë Sektorin e Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Studentore, organizojnë ditë të hapura për maturantët për t'u njohur me ofertat e universitetit. Në përpjekje për tërheqjen e studentëve në vitin e parë, UGJ ndjek praktika të ndryshme, përfshirë bashkëpunimin me shkollat e mesme dhe kontaktet e drejtpërdrejta me potencialet e

	studentëve, duke përfshirë ata që kanë përfunduar studimet parauniversitare në Greqi.
<b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	UGJ ka implementuar mekanizma efikase për të përcjellë informacionin lidhur me kriteret, procedurat e pranimit, transferimin e studimeve dhe diplomimin në faqen zyrtare [www.uogj.edu.al]. Kjo përfshin publikime të dokumenteve rregullative dhe lajme të aktualitetit, duke përdorur Sistemin Digjital të Sekretarisë Mësimore. Për të siguruar një akses të lehtë dhe të drejtpërdrejtë, sekretariatë mësimore në nivel institucional dhe fakulteteve, së bashku me zyrat e Alumni, Këshillin e Karrierës dhe Vlerësimin e Vazhduar, ofrojnë një burim konkret të informacionit. Për kandidatët e mundshëm, UGJ komunikon paraprakisht programet e studimit në portalin e maturës shtetërore, duke përfshirë kriteret e pranimit për secilin program. Ky shërbim ofron një gamë të diferencuar të informacionit, duke përfshirë edhe udhëzues studimesh, albume dhe spote publicitare. (Evidenca 5.33)
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UGJ ndjek një praktikë të zakonshme në publikimin e kriterëve dhe kërkesave për programet e studimit para fillimit të vitit akademik. Kjo përfshin një gamë të gjerë të mjeteve komunikuese, duke filluar nga faqja zyrtare e UGJ-së dhe përfunduar me kontakte direkte me individë dhe grupe të interesuar. Zyra e Alumni, Këshillimi i Karrierës dhe Vlerësimi i Vazhduar, në bashkëpunim me fakultetet dhe njësitë bazë, janë përgjegjëse për publikimin e informacioneve në faqen zyrtare të UGJ-së, rrjete sociale, media lokale, fletëpalosje, dhe postera, duke siguruar një informacion të plotë rreth programeve të studimit, diplomave, dhe mundësive të punësimit, përfshirë kriteret e veçanta për ndjekjen e tyre. (Evidenca 5.19.1, 5.19, 5.20, 2.20, 5.21, 5.21.1, 5.22).
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UGJ-ja, në përputhje me legjislacionin aktual, publikon çdo vit kriteret shtesë për përzgjedhjen e kandidateve me aftësi të veçanta dhe për përfshirjen e shtresave të marginalizuara, duke parashikuar vendet e tyre në kuotat vjetore pritëse (Evidenca 5.7). Përfshin masat infrastrukturore dhe mbështetjen për aksesin e tyre. UGJ ka ndërmarre hapa për të mbështetur këto kategori në përballjen e sfidave (Evidenca 5.7). Kujdeset për mos-diskriminim pozitiv të NJBGJLQGR, duke e shndërruar në një rast unik universitar dhe një aset pozitiv për UGJ, e vlerësuar gjatë akreditimit të vitit 2021 (Evidenca 5.1.1).
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni, në përputhje me rregulloren e programit të studimit, përgatit dhe publikon çdo vit kriteret për përzgjedhjen e studentëve nga shtete të tjera, duke përfshirë dhe kriteret specifike të caktuara për secilin vit akademik. Për studentët nga këto shtete, ofrohet mundësia e konvertimit të diplomave dhe ekuivalentimit të lëndëve, sipas dispozitave të Statutit të institucionit. (Evidenca 5.7, Evidenca 5.4, Evidenca 5.14)
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me	Institucioni, në përputhje me legjislacionin aktual, harton politika për bursa dhe ofron mbështetje financiare për shtresat në nevojë. Ky angazhim përfshin uljen e tarifës së studimit, rritjen e cilësisë së pranimit në programe prioritare, dhe kontributin në zhvillimin

përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	ekonomik të vendit. Njësia Baze siguron donacione vjetore për këtë qëllim, duke mbështetur rritjen e numrit të pranimeve dhe përmirësimin e cilësisë së studentëve në vitin e parë. Kjo traditë ka dhënë rezultate të shkëlqyera gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar. (Evidenca 5.32, Evidenca 2.10, Evidenca 2.9, Evidenca 2.9.1)			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UGJ implementon një politikë të qartë dhe transparente për pranimin dhe zhvillimin akademik të studentëve, të bazuar në legjislacionin vendas dhe Statutin e institucionit. Përcaktimi i kuotave dhe kriterëve nga Njësia Baze, i harmonizuar me VKM-të aktuale, ndodh një vit para fillimit të vitit akademik. NJBGJLQGR përcakton kuotat dhe kriteret e veta, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të UGJ. Politikat dhe dispozitat për trajtimin e studentëve janë në përputhje me ligjin dhe promovojnë barazi dhe drejtësi. Statuti dhe Rregullorja e Studimeve në UGJ rregullojnë trajtimin e studentëve dhe sigurojnë informacion të aksesueshëm për kandidatët nëpërmjet Mjeteve të Komunikimit Publik dhe portalit U-Albania.</i></p> <p><i>Informacioni për kandidatët është lehtësuar nga Sektori i Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Studentore, duke organizuar ditë të hapura për maturantët dhe duke ndjekur praktika për tërheqjen e studentëve në vitin e parë. Institucioni gjithashtu zbaton mekanizma efikase për publikimin e informacioneve në faqen zyrtare, përdorur një gamë të gjerë të mjeteve komunikuese dhe bashkëpunimin me strukturat kompetente.</i></p> <p><i>Sugjerohen praktika më efikase për tërheqjen e studentëve duke forcuar bashkëpunimin me shkollat e mesme dhe komunitetin.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregullorja institucionale dhe programet e studimit ofrojnë informacion për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve (Evidenca 1.2, 1.4, 1.5, 1.9). Fillimisht të vitit akademik, studentët marrin informacion në lidhje me procesin mësimor dhe orarin e mësimave në faqen zyrtare [ <a href="https://uogj.edu.al/">https://uogj.edu.al/</a> ]. Syllabus-i përmban detaje mbi vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve, prezantuar në fillim të çdo periudhe shkollimi për të bërë të qartë sfidat dhe kërkesat e vitit akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UGJ ofron informacion rreth kriterëve dhe procedurave të njohjes së kualifikimeve të mëparshme, transferimit të kredive dhe njohjes midis programeve studimore, duke ndjekur rregulloret dhe statutin e institucionit (Evidenca 1.1, 1.2, 1.5). Këto informacione janë të

	aksesueshme për studentët në fillim të vitit akademik në brendësi të UGJ dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë. Detaje të plota dhe dokumentacion i nevojshëm mund të gjenden pranë sekretarisë mësimore dhe në njoftimet e shpallura në stendat informative të UGJ (Evidenca 2.13).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Departamenti i GJLQGR, në bazë të Rregulloreve institucionale dhe Evidencave 1.2 dhe 1.9, informon studentët në fillim dhe gjatë vitit akademik rreth kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të dijeve për çdo lëndë dhe program studimi. Ky informacion përfshin sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, kontrollin e dijeve, kushtet për hyrjen në provim, organizimin e provimeve, komisionet e provimeve, zhvillimin e provimeve, shpalljen e rezultateve, ankimimin dhe mundësitë për përmirësim të notave (Evidencat 1.4, 1.5).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studentët në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" mund të diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Njësia Bazë informon studentët për provimin e përgjithshëm në fillim të vitit të tretë, duke ofruar pyetje përgjithësuese (Evidenca 1.10, 3.7, Tabela 10). Për punimin me mikrotezë, kriteret dhe procedurat janë të përcaktuara në rregulloret e institucionit dhe programit (Evidenca 1.4, 1.10). Studenti mund të propozojë temën dhe udhëheqësin, duke paraqitur kërkesën në fillim të vitit të tretë (Evidenca 1.4, 3.7.2). Procedurat duhet të respektojnë kriteret e përcaktuara nga UGJ dhe programi.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Para fillimit të çdo viti akademik dhe periodikisht, UGJ organizon takime të hapura dhe publikon udhëzues të posaçëm për informimin e maturantëve dhe të interesuarve mbi programet e studimit në UGJ [Evidenca 5.19.1]. UGJ gjithashtu informon përmes spoteve televizive dhe fletëpalosjeve promovuese për programet e studimit që ofron [Evidenca 2.20, Evidenca 2.20.1, Evidenca 5.21, Evidenca 5.22, Evidenca 5.21.1]. Njësia Bazë e GJLQGR ruan marrëdhëniet informuese me drejtoritë e shkollave dhe organizon takime informuese në grupe apo me individë të veçantë, duke përfshirë maturantë dhe prindër, si dhe faktorë komunitarë [Evidenca Tabela 21]. Efektivitetin e këtyre metodave e tregon tendenca në rritje e studentëve në vitet e para të viteve të fundit.
<b>Konkluzione</b>	<i>UGJ ofron informacion detajuar për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve (Evidenca 1.2, 1.4, 1.5, 1.9). Fillimisht të vitit akademik, studentët marrin informacion në lidhje me procesin mësimor dhe orarin e mësimëve në faqen zyrtare [https://uogj.edu.al/]. Syllabus-i përmban detaje mbi vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve. UGJ gjithashtu ofron informacion për njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe transferimin e kredive (Evidenca 1.1, 1.2, 1.5). Departamenti i GJLQGR informon studentët për procedurat e vlerësimit të dijeve (Evidencat 1.4, 1.5). Studentët në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" mund të diplomohen me provim përfundimtar ose punim diplome, dhe procedurat janë të përcaktuara në rregulloret (Evidencat 1.4, 1.10, 3.7.2). Para fillimit të vitit akademik dhe periodikisht, UGJ organizon takime dhe publikon udhëzues për</i>

	<i>informimin e maturantëve (Evidenca 5.19.1, 2.20, 2.20.1, 5.21, 5.22, 5.21.1). Njësia Bazë e GJLQGR ruan marrëdhëniet informuese me drejtoritë e shkollave dhe organizon takime informuese për studentët (Evidenca Tabela 21). Të gjitha këto përpjekje tregojnë efektivitetin e tyre në rritjen e numrit të studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në detaje për strukturën, organizimin, dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes Rregullores së Studimeve në UGJ, Rregullores së UGJ-së, si dhe Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek”, dhe përmes udhërrëfyesit për studentin (Evidenca 1.4, 1.2, 5.27). Kjo informacion është i qasshëm elektronikisht edhe në faqen zyrtare të UGJ-së. Gjithashtu, në fillim të çdo viti akademik, organizohen takime informuese me studentët e vitit të parë të studimeve nga UGJ dhe DGJLQGR.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të çdo viti akademik dhe në vijim, NJBGJLQGR ofron studentëve të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek” çdo informacion, udhëzim dhe rregullore që i siguron studentit personalitet dhe autoritet, duke përfshirë njohjen e plotë me programin, planin mësimor, lëndët dhe përmbajtjen e tyre, si dhe gjithë veprimtaritë formuese në ciklin e studimeve (Evidenca 1.10, 3.1). Informacioni i detajuar për studentët gjithashtu është i aksesueshëm në faqen zyrtare të UGJ-së: <a href="http://www.uogj.edu.al">www.uogj.edu.al</a> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Alumni, Këshillimi i Karrierës dhe Vlerësimi të Vazhduar në UGJ, ndihmon studentët të gjejnë mundësi të punësimit (Evidenca 3.3, 2.13.1, Tabela 23). UGJ merr pjesë në panairë dhe ofron informacione për punësim dhe mundësitë e punëdhënësve të ardhshëm (Evidenca 2.20, 2.20.1). Në të njëjtën kohë, Njësia Bazë e GJLQGR operon një sistem për ndihmë të diplomuarit në gjetjen e punës, duke shënuar një nivel të lartë të suksesit në punësimin e të diplomuarve të NJBGJLQGR. Megjithatë, mungesa e praktikës profesionale mund të dobësojë arritjen e objektivave për zhvillimin e aftësive, sidomos atyre profesionale, duke sjellë sfida në përballjen e problematikave komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e studimit të specializuar ose profesionit.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor,	Njësia Bazë ofron te studentët informacion të plotë dhe të përditësuar lidhur me strukturën mësimore, planin mësimor, orarin e mësimave, kalendarët e provimeve, dhe njoftimet përmes disa kanaleve, duke përfshirë stendën e Informimit pranë Njesisë Bazë, sekretarinë

logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	mësimore, faqen zyrtare të internetit, postën elektronike personale dhe rrjetet sociale.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni për programin e studimit është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë për studentët përmes disa kanaleve, duke përfshirë faqen zyrtare të internetit të UGJ, postën zyrtare elektronike dhe sistemin e sekretarisë mësimore. Njësia Bazë gjithashtu operon një faqe Facebook me menaxhim të brendshëm, duke përdorur këtë platformë për koordinim dhe bashkëveprim në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe aktiviteteve akademike. Faqja Facebook mund të gjendet në <a href="https://www.facebook.com/tmimaellargyr">https://www.facebook.com/tmimaellargyr</a> .			
<b>Konkluzione</b>	<i>Studentët informohen përmes rregulloreve të institucionit dhe programit, duke përfshirë njohjen me lëndët, planin mësimor dhe aktivitetet formuese. NJBGJLQGR ofron informacion të plotë për studentët e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek", përfshirë programin dhe planin mësimor. Zyra e Alumni dhe Këshillimi i Karrierës në UGJ kontribuojnë në gjetjen e mundësive të punësimit. Njësia Bazë e GJLQGR siguron informacion lidhur me strukturën mësimore dhe njoftimet përmes kanaleve të ndryshme. Informacioni për programin e studimit është lehtësisht i arritshëm për studentët në distancë përmes faqes zyrtare, postës elektronike dhe sistemit të sekretarisë mësimore. Megjithatë, mungesa e praktikës profesionale mund kufizuar zhvillimin e aftësive, sidomos atyre profesionale, sjellë sfida në përballjen e problematikave komplekse në fushën e studimit ose profesionit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Statistikat vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" janë të aksesueshme përmes bashkëpunimit të specialistit të Statistikës me Sekretarinë Mësimore të FESHSH. Ky bashkëpunim siguron mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, dhe paraqitjen e informacioneve statistikore nga regjistri themeltar i studentëve, regjistri i arritjeve akademike, regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave, duke ofruar një bazë të qëndrueshme për përcaktimin e periudhës së lejueshme për vazhdimin e studimeve dhe për detyrimet e tjera mësimore dhe akademike në vitet e ardhshme.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga	UGJ ka në dispozicion statistika vjetore të detajuara për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, duke përfshirë tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, dhe diplomimin e tyre. Ky informacion vjen nga bashkëpunimi i UGJ me



<p>programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>specialistët e Statistikës dhe Sekretarinë Mësimore, përfshirë evidencat 1.18, 1.19, 1.20, 1.21, si dhe 5.10 dhe Tabelën 21. Këto statistika ofrojnë një pasqyrë të plotë dhe të përditësuar të zhvillimit të studentëve në programin e studimit, duke ndihmuar në monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së ofruar nga UGJ.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Përmes Sekretarisë Mësimore dhe sistemit Pitagora (ESSE3), UGJ menaxhon të dhënat statistikore të studentëve, duke përdorur një kombinim të metodave manuale dhe elektronike. Ky proces siguron sigurinë dhe zbatimin e rregullave ligjore. Të dhënat e statistikave janë lehtësisht të gjatshme për personat e autorizuar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Njësitë përbërëse të UGJ kryejnë veprimtarinë e tyre në pajtueshmëri me aktet. Përmes kontrollit periodik, UGJ vlerëson dokumentacionin në Njësitë bazë, kryesore dhe Sekretarive mësimore, duke dokumentuar situatën dhe siguruar saktësinë e informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre [Evidenca 5.23, Evidenca 5.23.1].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>NJBGJLQGR mbledh dhe analizon të dhëna mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe për punësimin e tyre. Institucioni përdor këto informacione për të hartuar raporte periodike dhe strategji të përmirësimit. Kuadri vlerësues bazohet në Strategjinë e Njësive Bazë 2020-2025 [Evidenca 1.11]. Raportet e NJBGJLQGR integrohen në raportet më të gjera të FESHSH dhe UGJ-së, shtohet nga raportet e Fakulteteve, Sekretarive Mësimore, Drejtorisë së Shërbimeve Akademike, Zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar [Evidenca 1.20, Evidenca 1.21, Evidenca 2.13.1].</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UGJ, në bashkëpunim me specialistin e Statistikës në FESHSH, siguron statistika vjetore për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek" (Evidenca 1.18, 1.19, 1.20, 1.21, 5.10, Tabela 21). Menaxhimi i këtyre të dhënave zhvillohet përmes Sekretarisë Mësimore dhe sistemit Pitagora (ESSE3), duke garantuar zbatimin e rregullave ligjore (Evidenca 5.30, 5.12, 2.13.1). Në të njëjtën kohë, Njësitë përbërëse të UGJ kryejnë kontrolle periodike të dokumentacionit dhe vlerësojnë saktësinë e informacionit lidhur me studentët (Evidenca 5.23, 5.23.1).</i></p> <p><i>NJBGJLQGR, në kuadër të veprimtarisë së saj, analizon të dhëna mbi profilin, cilësinë dhe punësimin e studentëve, duke hartuar raporte dhe strategji përmirësimi (Evidenca 1.11). Këto raporte integrohen në dokumentacionin më të gjerë të FESHSH dhe UGJ-së, duke përfshirë raportet e Fakulteteve, Sekretarive Mësimore, Drejtorisë së Shërbimeve Akademike, Zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar (Evidenca 1.20, 1.21, 2.13.1). Ky proces monitoron dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve të ofruara nga UGJ, duke prezantuar rezultatet në raporte periodike.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Sipas Statutit [Evidenca 1.1], UGJ inkurajon pjesëmarrjen aktive të studentëve në organet kolegjiale të institucionit. Ata përfaqësohen në Senatin Akademik [Evidenca 2.15], Këshillin e Etikës [Evidenca 1.1], Njësinë e Sigurimit të Cilësisë [Tabela 24], komisionet zgjedhore dhe vlerësuese. Gjithashtu, ata marrin pjesë në vendimmarrjen e Njësisë Bazë dhe vlerësojnë performancën e stafit akademik. Këshilli Studentor dhe Shoqata Sportive Studentore [Evidenca 5.13, 5.13.1, 5.24, 5.24.1] janë platforma tjera ku ata shprehin dhe ndajnë mendimet e tyre.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bazuar në Statutin e tij, UGJ siguron përfshirjen e studentëve në procese vendimmarrëse dhe vlerësuese mbi aspektet akademike dhe administratë. Përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik shprehin mendime dhe propozime për çështje të përgjithshme akademike [Evidenca 1.1, Evidenca 2.15]. Studentët organizohen në Këshillat Studentore dhe janë pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit [Evidenca 5.13, Evidenca 5.6]. Ata janë pjesë e Këshillit të Etikës dhe marrin pjesë aktivisht në sondazhe vjetore të studentëve [Tabela 24].
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	UGJ, në përputhje me Statutin dhe aktet rregulluese, inkurajon pjesëmarrjen aktive të studentëve në proceset vendimmarrëse dhe vlerësuese. Studentët kanë të drejtë të shprehen në lidhje me çështje të ndryshme, duke përfshirë planet dhe programet e studimeve, cilësinë e shërbimeve, tarifën, dhe kontribute financiare. NJBGJLQGR vlerëson kontributin e studentëve si pjesë e procesit akreditues, duke reflektuar propozimet e tyre dhe duke u mbështetur në bashkëbisedime të lira. Anketat vjetore të studentëve përbëjnë burim të rëndësishëm për vlerësimin e performancës së institucionit dhe përmirësimin e programit të studimit [Evidenca 6.3].
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, duke përfshirë ankimin dhe rezultateve nga studentët, është përcaktuar në të gjitha Rregulloret institucionale, përfshirë Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca 1.2, 1.5, 1.9, 1.4].  Megjithatë, evidenca nuk jep informacion specifik rreth një procesi të strukturuar të ankimit nga ana e studentit dhe procedurës së ndjekur konkretisht për finalizimin e ankimit.
<b>Konkluzione</b>	UGJ inkurajon pjesëmarrjen aktive të studentëve në organet kolegjiale dhe proceset vendimmarrëse duke i përfshirë në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Njësinë e Sigurimit të Cilësisë,

	<p>komisionet zgjedhore dhe vlerësuese, si dhe Këshillin Studentor dhe Shoqatën Sportive Studentore. Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e tyre në çështjet akademike dhe administrative, duke u mundësuar të shprehen në lidhje me planet e studimit, cilësinë e shërbimeve, tarifat dhe kontributet financiare. NJBGJLQGR vlerëson kontributin e studentëve në procesin akreditues, ndërsa anketat vjetore të studentëve janë burim i rëndësishëm për vlerësimin dhe përmirësimin e performancës së institucionit dhe programit të studimit. Për sa i përket procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë ankimit dhe rezultateve nga studentët, procedurat janë përcaktuar në rregulloret institucionale, duke theksuar nevojën për një strukturë dhe procedurë të qartë për finalizimin e ankimit. Megjithatë, rast konkret të procesit të ankimit nuk është paraqitur në mënyrë specifike në evidencat aktuale.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-akademike Administrative dhe Sektori i Shërbimeve Bibliotekare Arkivore dhe Studentore, përmes zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar [Evidenca 1.1 S Evidenca 3.3], ofron shërbime informative dhe mbështetëse për studentët në çështjet mësimore në UGJ. Kjo përfshin orientimin e aplikantëve dhe studentëve të rinj, informacionin mbi programet dhe kurrikulat e studimeve, këshillimin për diplomimin dhe mundësitë e studimeve të larta, si dhe asistencën për punësim në sektorin publik dhe privat. Drejtoria bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin e praktikave profesionale, duke ofruar trajnime, info day, takime të hapura, ndërsa informimi i studentëve realizohet edhe përmes faqes zyrtare të universitetit dhe rrjeteve sociale. DGJLQGR ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e informacionit dhe mbështetjes së studentëve në çështje mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen, këshillohen, ndiqen dhe informohen nëpërmjet disa burimeve në UGJ. Njësia bazë, përgjegjësitë, titullarët e lëndëve dhe stenda e Informimit ofrojnë shërbime në këtë drejtim. Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Sektori i Standardeve dhe Kurrikulave, si dhe Zyrat e Alumni dhe Këshillimit të Karrierës Vlerësimit janë gjithashtu burime kyçe për mbështetjen dhe ndjekjen e studentëve në çështjet mësimore. Faqja zyrtare e internetit, sistemi i Sekretarisë Mësimore (Pitagora), njoftimet elektronike dhe rrjetet sociale, si Facebook, përdoren për të siguruar informacionin e nevojshëm dhe për të përcjellë njoftimet e rëndësishme.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar në UGJ ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët. Ata sigurojnë informacion dhe këshilla për çështjet mësimore, programet e studimeve dhe diplomimin. Gjithashtu, ndihmojnë studentët që kanë përfunduar studimet në nivelin e parë për të gjetur mundësi për vazhdim të studimeve ose për punësim. Ky zyrë bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin e praktikave profesionale, duke ofruar trajnime dhe shërbime të tjera të përmirësuara për zhvillimin e studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar ndjek studentët pas diplomimit, mbledh dhe përpunon të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të diplomuarve të programit të studimit. Këto informacione janë të disponueshme për studentët dhe organe të autoriteteve drejtuese përkatëse. (Evidenca 5.2, 5.26.1, 5.34, 2.13.1)</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-akademike Administrative dhe Sektori i Shërbimeve Bibliotekare Arkivore dhe Studentore, përmes zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, ofrojnë shërbime mbështetëse dhe informative për studentët në aspektet mësimore në UGJ. Këto shërbime përfshijnë orientimin e aplikantëve, informacionin mbi programet dhe kurrikulat e studimeve, këshillimin për diplomimin dhe mundësitë e studimeve të larta, si dhe asistencën për punësim në sektorin publik dhe privat. Bashkëpunimi i ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore, si dhe përdorimi i rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të universitetit, shërbejnë për të siguruar një përkrahje të efektshme për zhvillimin e studentëve në aspektin mësimor. Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, ndjek studentët pas diplomimit, ofron informacion dhe këshilla për çështjet mësimore, programet e studimeve dhe diplomimin, ndihmon studentët për vazhdimin e studimeve apo punësimit, dhe mbledh të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të diplomuarve të programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UGJ ofron udhëzues, manuale dhe trajnime institucionale për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. Kjo përfshihet në udhëzuesin institucional (Evidenca 3.11). Bazuar në rregulloren e studimeve Bachelor, UGJ përdor metoda didaktike inovative dhe teknologji në mësimdhënie (Evidenca 3.11). Gjatë pandemisë Covid-19, UGJ siguroi mësim online përmes platformave si Office 365 dhe Microsoft Teams, duke ofruar udhëzime dhe manuale për përdorimin e tyre (Evidenca 3.2.1 - 3.2.10, 3.2.13).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Siç edhe shprehet në RVB, GJ vlerëson cilësinë si "pasaportën e një universiteti modern për njohjen sociale dhe përsosmërinë akademike". Për ta arritur këtë, anëtarët akademikë dhe administrativë të UGJ janë përfshirë në një strukturë të qartë, e udhëhequr nga Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikilave (SSCK), në përputhje me Statutin e UGJ, i cili monitoron, vlerëson, dhe promovon vazhdimisht cilësinë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore. Kjo përfshin organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin periodik të cilësisë së programeve studimore, dhe raportet vjetore të cilësisë (Evidenca 6.7, 6.11, 6.11.1, 6.11.2).  Në UGJ, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ka politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë, mbështetur në standardet shtetërore dhe udhëzimet evropiane. Kjo përfshin hartimin e rregullores së cilësisë, vlerësimin dhe përmirësimin e sistemit të cilësisë në universitet (Evidenca 6.9, 6.10, 6.1, 6.5, 6.5.1).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	UGJ, sipas Statutit, përfshin studentët në vlerësimin periodik të mësimdhënies dhe dijeve. Studentët monitorojnë përgatitjen e tyre dhe ndikojnë në cilësinë e shërbimeve. Njësia Bazë e GJLQG zhvillon pyetësorë për dobësitë në mësimdhënie dhe performancën e stafit akademik, me rezultatet të diskutuara në mbledhjet e Departamentit (Evidenca 6.7, 6.12, 6.3). Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në nivelet institucionale dhe bazë (Evidenca 1.1). Rregullorja e studimeve siguron të drejtën e studentit për ankimim të rezultateve (Evidenca 1.4).
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, u referohet kriterëve dhe objektivave të përcaktuara periodikisht nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së institucionit. Rezultatet janë raportuar tek strukturat e menaxhimit dhe publikimit të UGJ, të cilat i bëjnë të njohura përmes faqes zyrtare <a href="https://uoj.edu.al/transparenca/">https://uoj.edu.al/transparenca/</a> (Evidenca 6.2, 6.2.1). Këto informacione publike përfshijnë sukseset në mësimdhënie dhe politikat për sigurimin e cilësisë brenda institucionit.

	Gjithashtu, ka propozime për ngritjen e cilësisë së punës në institucion dhe në Njësinë Bazë të GJLQGR, e cila është dokumentuar në raportin vjetor të UGJ për vitin akademik 2021-2022 dhe raportin mbi aktivitetin mësimor-kërkimor të DGJLQG për të njëjtën periudhë (Evidenca 6.6, 1.21, 3.8).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira. nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UGJ inkurajon praktikatat e mira në mësimdhënie duke përdorur mekanizmat e vlerësimit dhe rezultateve të marra. Të dhënat nga Raporti Vjetor i UGJ, Raporti i Veprimtarisë Shkencore dhe Plani i Veprimtarive Akademike për vitin akademik 2021-2022 shërbejnë si mjete për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të personelit akademik (Evidenca 1.21, 3.9.2, 3.10).			
<b>Konkluzione</b>	<i>UGJ shfaq një qasje progresive dhe angazhim të vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes inovacionit dhe përdorimit të teknologjisë. Me udhëzues, manuale dhe trajnime institucionale, institucioni promovon praktika të mira në mësimdhënie. Përballë sfidave të pandemisë Covid-19, UGJ siguroi një tranzicion të suksesshëm në mësimin online duke ofruar udhëzime dhe resurse të nevojshme teknologjike për përdorimin e platformave, siç dëshmojnë evidencat specifike. Kjo përkushton një angazhim të vazhdueshëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, përfshirë përdorimin e mekanizmave të vlerësimit dhe analizave të rezultateve. Gjithashtu, UGJ ndjek një qasje të strukturuar dhe transparente për cilësinë nëpërmjet Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe ka synim për një përjasje të vëmendshme ndaj sugjerimeve dhe propozimeve për ngritjen e cilësisë në të gjitha nivelet e institucionit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UGJ, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Neni 103, ka hartuar politika dhe themeluar struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, siç përcaktohet në Strategjinë e Zhvillimit të UGJ 2020-2025 (Evidenca 1.3). Rregullorja e NJSBC, e cila bazohet në nenet 5, 6, dhe 7, përcakton qartë politikatat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke respektuar parashikimet ligjore dhe rregullore të institucionit. Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave, i cili operon në kuadër të Statutit të Universitetit Eqrem Çabej (Neni 93), është struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së vazhdueshme në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe zhvillim cilësor në UGJ (Evidenca 1.1, 1.7).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e	Sistemi i Sigurimit të Cilësisë në UGJ, përfshirë Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektorin e Standardeve të Cilësisë, ndjek

<p>Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>një strategji për përmirësimin e cilësisë. Ky sistem inkurajon pjesëmarrjen e studentëve dhe bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm, sipas dokumenteve si Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025 dhe Strategjia e Departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek për periudhën 2020-2025 (Evidenca 1.3, 1.11). Rregullorja e NJSBC dhe Statuti i UGJ përcaktojnë përfshirjen e studentëve në vlerësimin e brendshëm të programeve dhe proceseve institucionale (Evidenca 6.1, 1.1). Për rritjen e cilësisë, UGJ bashkëpunon me organizata studentore, bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm (Evidenca 1.12). Marrëveshjet e bashkëpunimit, si ato me Universitetin e Maqedonisë Perëndimore dhe Universitetin e Janinës, kontribuojnë në shkëmbimin e eksperiencës dhe zhvillimin e eventeve shkencore dhe kulturore (Evidencat 3.12, 3.13).</p> <p><b>Në lidhje me programin specifik të studimit, GVJ do të donte të shikonte edhe zbatimin e politikave dhe praktikave të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, pasi si në RVB-në, ashtu edhe në vizita në terren nuk arriti të grumbullonte të dhëna për dokumentimin e zbatimit e kërtyre në programin e studimit nën vlerësim, me përjashtim të një pyetësori në gjuhën greke të administruar nga vetë Departamenti, përpunimin, rezultatet dhe veprime të mëtejshme nuk u paraqitën GVJ-së.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UGJ ka përfunduar me sukses procesin e akreditimit periodik institucional, duke marrë Vendimin Nr. 67 më datë 21.09.2017 dhe Vendimin Nr. 55 më datë 16.12.2021 nga Bordi i Akreditimit të ASCAL. Këto vendime dhe certifikatat e akreditimit janë dokumentuar në faqen zyrtare të UGJ-së (<a href="https://uogj.edu.al/vendimi-ba-dhe-certifikata-e-akreditimit/">https://uogj.edu.al/vendimi-ba-dhe-certifikata-e-akreditimit/</a>), duke konfirmuar cilësinë dhe përputhshmërinë e institucionit me standardet e përcaktuara nga organi akreditues.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>SSCK, në përputhje me Statutin e UGJ (Evidenca 1.1), kontrollon dhe vlerëson cilësinë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore. Për këtë, zhvillon studime gjurmuese për punësimin e studentëve, dhe kryen vlerësime periodike të cilësisë së programeve studimore dhe institucionit (Evidenca 6.12, 5.2). Ky proces synon të identifikojë sukseset dhe sfidat për të ndërmarrë masa përmirësuese në të ardhmen.</p> <p><b>Sugjerim: Hartimi i pyetësorëve si një instrument matës për treguesit e cilësisë mbetet një sfidë dhe detyrim për zyrën e Cilësisë, kjo në përputhje me kërkesat e standardit.</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UGJ, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe Strategjinë e Zhvillimit 2020-2025, ka vendosur politika dhe struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. NJSBC dhe Sektori i Standardeve të Cilësisë, duke përfshirë studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, ndjekin një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Akreditimi nga ASCAL dhe monitorimi nga SSCK dëshmojnë përpjekjet e UGJ për cilësi të lartë. Bashkëpunimi me institucione të tjera kontribuon në shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e bashkëpunimit. <b>Mbetet</b></p>

	<i>zgjërimi i veprimtarisë përkatëse në mënyre rigoroze edhe të ky program studimi.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë. që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	UGJ implementon mekanizma dhe procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit të ciklit të parë. Në nivel institucional, UGJ zhvillon çdo vit Raportin Vjetor, bazuar në Raportet Vjetore të Departamenteve dhe Fakulteteve. Ky raport përfshin analizat e procesit mësimor dhe kërkim shkencor nëpër një varg dokumentesh zyrtare (Evidenca 1.21, 1.16, 3.8). Njësia Bazë e GJLQGR ndjek rregullisht realizimin e programit të studimit, vlerëson rezultatet e studentëve, analizon rezultatet mesatare për semestër, dhe monitoron studentët gjatë praktikës profesionale dhe përgatitjes së diplomës. Të gjitha këto informacione përfshihen në raportin vjetor të Departamentit.
<b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet vjetore institucionale dhe raportet e vlerësimit të cilësisë nuk përfshijnë mjaftueshëm rezultatet e pritshme në të ardhmen dhe nuk ofrojnë strategji të mjaftueshme për adresimin e mangësive. Këto dokumente gjithashtu mungojnë në përfshirjen e instrumenteve për përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe në motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët (Evidenca 1.21, 1.16, 3.8).  <i>Sugjerohet që institucioni të avancojë raportet dhe strategjitë e cilësisë duke përfshirë qëllime afatshkurtra, duke siguruar një kanal të rregullt të komunikimit për feedback nga personeli akademik dhe studentët, dhe duke përdorur mjete specializuara për vlerësimin e cilësisë.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës,	RBV pranon se në Njësinë Bazë të GJLQG, duhet të përmirësohen përpjekjet për vlerësimin e kurrikulës, duke i dhënë një strukturë dhe standarde më të qëndrueshme. Zbatimi i akteve normative ka nevojë për sistematizim më të mirë. Vlerësimi i kurrikulës duhet të përqendrohet në një kërkesë të brendshme për cilësi të përbashkëta dhe përmirësimin e proceseve. Problemet me vlerësimin paralel të provimeve dhe testimin lokal duhet të adresohen për të përmirësuar efektivitetin dhe objektivitetin. Masa shtesë për organizim dhe standardizim mund të ndihmojnë në këtë drejtim.



testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Për të përmirësuar cilësinë e veprimtarive akademike në Njësinë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek në UGJ, institucioni mund të fokusohet në standardizimin e proceseve të vlerësimit të kurrikulës dhe rritjen e përfshirjes së studentëve. Një vëmendje e veçantë mund të kushtohet zgjidhjes së sfidave në vlerësimin e provimeve dhe testimin lokal për të garantuar një proces objektiv dhe të integruar.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Njësia Bazë e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek përdor pyetësorë, teste dhe sondazhe për vlerësim, duke synuar matjen e performancës së stafit akademik dhe cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit. Këto metoda sigurojnë një analizë të detajuar të performancës së programit në përputhje me nevojat e studentëve dhe standardet e përcaktuara. (Evidenca 6.3, Tabela 23)			
<b>Konkluzione</b>	<i>UGJ ka procese formale për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, duke dokumentuar ato në Raportin Vjetor. Megjithatë, raportet e cilësisë nuk përfshijnë mjaftueshëm qëllime afatshkurtra dhe strategji për përmirësime. Në Njësinë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek (GJLQG), përpjekjet për vlerësim nuk janë të standardizuara dhe permanente. Për përmirësim, sugjerohet standardizimi i proceseve të vlerësimit dhe rritja e përfshirjes së studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Njësia bazë e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek zbaton politika dhe procedura të brendshme të cilësisë për programet e studimit. Ajo angazhohet në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit, duke përfshirë aktorë të jashtëm të interesuar. Bashkëpunimi me institucione analoge, veçanërisht jashtë vendit, shprehet në bashkërendimin e përpjekjeve për zhvillimin e një programi të përbashkët. Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave mund të përdorë ekspertë të jashtëm sipas nevojës, për konsulencë dhe ekspertizë. Për vlerësimin e brendshëm, një grup përfshin një përfaqësues nga organizata studentore dhe mund të ftohen edhe ekspertë të jashtëm sipas nevojës. Gjithashtu, për përmirësimin e

	përbajtjes së programit dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës, zyra e Alumni dhe Këshilli i Karrierës janë pjesëmarrës dhe promovojnë programet në evente të ndryshme, duke marrë parasysh propozimet dhe eksperiencat e maturanëve dhe studentëve.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni promovon rolin e individëve dhe studentëve për sigurimin e cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë rol kyç në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Përgjegjësia për rezultate jo të pritshme duhet të pranohet dhe të shqyrtohet me përgjegjësi. (Evidenca 1.1, Evidenca 3.3, Evidenca 6.1, Evidenca 1.9, 1.10)			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Institucioni thekson rëndësinë e rolit të individëve dhe studentëve në sigurimin e cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Në këtë proces, është e nevojshme të pranohet përgjegjësia për rezultate që nuk janë të pritshme dhe të shqyrtohet me përgjegjësi. (Evidenca 1.1, 3.3, 6.1, 1.9, 1.10)  Për të përmirësuar rezultatet, mund të sugjerohet trajnimi dhe përfshirja e studentëve dhe monitorimi i vazhdueshëm për arritje më të mira.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në Njësinë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, në UGJ, nuk janë evidentuar dukuri negative në lidhje me cilësinë e procesit mësimor dhe fushën akademike. Përpjekjet janë bërë për të trajtuar edhe dobësitë në mënyrë të kujdesshme dhe jo të drejtpërdrejtë. Aktet normative të brendshme janë taksative dhe rigorozë, duke përfshirë Kodin e Etikës dhe rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, duke iu mbështetur në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. (Evidenca 3.5, 4.11)			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Departamenti ka zhvilluar marrëveshje të bashkëpunimit me institute ndërkombëtare si Universiteti Janinës dhe Universiteti i Maqedonisë Perëndimore. Përmes këtyre marrëveshjeve, pedagogë nga universitetet bashkëpunuese japin kontribute dhe vlerësime mbi programin e studimit, cilësinë e studentëve dhe shërbimet. Aktivitete të tilla përfshijnë konferenca ndërkombëtare, mbrëmje poetike, leksione të hapura dhe pjesëmarrje në seminare kualifikuese për mësuesit (Evidenca 3.12, 3.13)			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Njësia Bazë ka politika të brendshme për cilësi, përfshirë aktorë të jashtëm dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Zyra e Alumni dhe Këshilli i Karrierës promovojnë programet në evente. Institucioni vlerëson rolin e individëve dhe studentëve për cilësi, ndërsa Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë rol kyç.</i></p> <p><i>Për përmirësim, sugjerohet trajnim dhe përfshirje e studentëve. Aktet normative janë taksative. Bashkëpunimi ndërkombëtar ka kontribute pozitive. Departamenti trajton me kujdes dobësitë dhe ndërthur efektivisht standarde dhe akte normative.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UGJ përcakton një parim kryesor në drejtim të transparencës dhe publikon informacionin lidhur me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë nëpërmjet faqes zyrtare dhe programit të transparencës. Në këtë drejtim, përfshihen mekanizmat kontrollues, planet strategjike, raportet vjetore të veprimtarive akademike dhe monitorimit të cilësisë së programeve të studimit. Njësia Bazë ndjek këtë praktikë duke përdorur mjetet e veta të komunikimit në faqen e internetit dhe në faqen e Facebook të departamentit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UGJ, në përputhje me parimet e lirisë dhe etikës akademike, si dhe në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale, respekton këto vlera në publikimin e rezultateve dhe vlerësimeve të programeve të studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raportet e vlerësimit i trajtojnë pikat e forta dhe të dobëta, duke hartuar detyra dhe afate për përmirësim. Kjo praktikë përputhet me dokumentet zyrtare si Planin e veprimit për Akreditimin institucional (Evidenca 6.4) dhe Propozimet për ngritjen cilësore të punës në Njësinë Bazë (Evidenca 6.6).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së brendshme në UGJ, përfshirë edhe Njësinë Bazë të GJLQG, nuk duhet të reduktohen në formalitete rutinore. Përdorimi efektiv i këtyre proceseve ka një qëllim thelbësor: përmirësimin vazhdueshëm të cilësisë, dhe humbja e këtij synimi do të zvogëlonte ndjeshëm efektivitetin dhe kuptimin e tyre.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek zbaton veprimtari periodike, përfshirë sondazhe, anketime, dhe plotësimin e formularëve të kontrollit. Këto aktivitete janë pjesë e një strategjie afatgjatë për sigurimin e cilësisë në programet e studimit dhe zhvillimin e tyre. Përmes fushatave informuese, personeli akademik dhe studentët janë të ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e përmirësimit të cilësisë dhe janë inkurajuar të marrin pjesë aktivisht. (Evidenca 6.3, 1.11, 6.6)
<b>Konkluzione</b>	<i>UGJ, me transparencë, publikon informacionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në faqen zyrtare dhe programin e transparencës, duke përfshirë mekanizmat kontrollues dhe raportet vjetore. Njësia Bazë e GJLQG ndjek këtë praktikë në komunikimin online. Institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike, publikon rezultatet dhe vlerësimet e programeve të studimit, duke hartuar detyra dhe afate për përmirësim. Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek synon të përdorë sondazhe dhe anketime për sigurimin afatgjatë të cilësisë, inkurajon pjesëmarrjen aktive të</i>

	<i>personelit dhe studentëve. Mbetet një zbatim më rigoroz i politikave, proceseve dhe veprimtarive për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit për të rritur efektivitetin e tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>			<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>			<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrër.”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit ofrohet nga një institucion me histori, duke mbartur një ‘markë’ të njohur në Republikën e Shqipërisë.
2. Institucioni operon në një zone me pakica etnike dhe gjuhësore-kulturore dhe departamenti që organizon programin e studimit tregon një nivel të lartë ndjeshmërie karshi nevojave të këtyre pakicave, njerën prej të cilave edhe i shërben ky program studimi.
3. GVJ pohon se departamenti ka dëshmuar interes dhe përpjekje të përqëndruara për të shtuar burimet e tij njerëzore akademike, në mënyrë që t’i përmbushë standartet shtetërore.
4. Lidhje të forta midis programit të studimit dhe departamentit ofruet me IAL të afirmuara të Greqisë.
5. GVJ-ja pohon se Departamenti ka dëshmuar ndërgjegjeje karshi hapave që mund të ndërmarren për përmirësimin e kulturës së cilësisë.

**Pika të dobëta:**

1. Pavarësisht përmirësimeve të fundit, GVJ-ja ka konstatuar se për një kohë jo të shkurtër programi i studimit nën vlerësim dhe departamenti organizues i tij ka operuar me staf të pamjaftueshëm akademik dhe se rekrutimi i stafit akademik me kualifikime dhe veprimtari kërkimore-shkencore që të përputhen me fushat e lëndëve që ofrojnë mbetet sfidë. Shënohet këtu se programet e doktoraturës kanë patur një ngrirje disavjeçare që ka penguar rritjen e kualifikimeve të pedagogëve me kontratë.
2. Ngarkesa mësimore është e madhe, jo në tejkallim të orëve suplementarë të parashikuara me akte nënligjore, por në masë që ekspertiza e tyre të mos paraqitet gjithmonë në përputhje me të gjithë lëndët që u janë akorduar.
3. Lidhje jo sistematikisht të kultivuara me aktorët e biznesit vendas ose të huaj, të atribuara edhe në mungesën e parashikimeve kurrikulare për praktika.
4. Kultura e cilësisë është ende në fazën e saj të formësimit, si përkundrejt vlerësimit nga studentët, ashtu edhe atij nga të barabartit.

**Rekomandime:**

1. Departamenti sugjerojmë të rishikojë kurrikulën e programit të studimit për të siguruar se elementet e saj i përmbahen plotësisht akteve nënligjore në fuqi.



2. Sugjerojmë që departamenti të shikonte mundësitë e reduktimit të ngarkesave mësimore të personelit akademik, në dobi të kërkimit shkencor dhe në përputhje me të ngushtë me specializimin e tij.
3. Departamenti sugjerohet të rishikojë kodin e këtij programi studimi, në vartësi të përgjigjes nga Ministria e Arsimit.
4. Sugjerojmë që, në rastin e rritjes së numrit të studentëve, Departamenti të emërojë një koordinator për secilin program studimi që ofron.
5. Rekomandohet që, me rishikimin e kurrikulave të programit të studimit, Departamenti të reflektojë nëqoftëse është e përshtatshme për karakterin e programit të studimit që, në fushat e letërsisë dhe qytetërimit grek, lëndat e viteve të avancuara të mos zgjerojnë vetëm linearisht njohuritë e përftuara më parë, por edhe t'i thellojnë me qasje më të dukshme krahasuese dhe koncepte më të avancuara. Në fushën e Pedagogjisë sugjerohet që Departamenti të reflektojë mbi mundësinë që lënda "Hyrja në Shkencat e Edukimit dhe Metodologjia e Edukimit" të caktohet para lëndës më të avancuar "Mjedisi në Lëndët Shkollore të Arsimit Fillor". Po ashtu, rekomandojmë që Departamenti të reflektojë mbi fuqizimin e elementeve të praktikës përgjatë kurrikulës. Sugjerohet që në procesin e rishikimit të kurrikulës të përfshihen student dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës dhe gjetiu që mund të japin kontribut të çmuar.
6. Sugjerohet një përditësim më të shpeshtë të programeve lëndore (silabuse) me literaturë më të përditësuar.
7. GVJ-ja sugjeron që Departamenti të reflektojë mbi rishikimin e mundshme të strukturës së vlerësimit, në mënyrë që të ulet pesha e provimit përfundimtar dhe të fuqizohen komponente të tjera për një vlerësim të vazhdueshëm me peshë më të madhe.
8. Rekomandojmë që Departamenti të ruajë provimet dhe tezat e tyre, si edhe punimet e diplomës për një periudhë të paktën të barabartë me një cikël akreditimi. Ruajtja e tezave të diplomave mund të ndihmojë Departamentin edhe në kontrollimin e autenticitetit të tezave të diplomës.
9. GVJ-ja sugjeron krijimin, në rang institucional, të një Qendre për Mësimdhënien dhe të Nxënit, me synim rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.
10. Sugjerojmë që personeli akademik të synojë publikimin e punimeve të tyre shkencore te revista ndërkombëtare të indeksuara dhe të rankuara (p.sh SCOPUS, Clarivate Analytics) ose te shtëpia botuese të rankuara (SENSE Academic Publishers).



**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Greek Language, Literature and Civilization" on offer by the Higher Education Institution "“Eqrem Cabej” University of Gjirokastrër.”**

**Strengths and affirmations**

1. The study programme is offered by a HEI with some historical background, thereby bearing a known 'brand' name in the Republic of Albania.
2. The HEI operates in a zone with ethnic and linguistic/cultural minorities and the department organising the study programme demonstrates a high level of sensitivity towards the needs of these minorities, one of which is directly served through this study programme.
3. The External Assessment Group acknowledges that the Department has demonstrated a concerned and concentrated effort to enhance its academic human resources to meet state standards.
4. Strong links of the study programme and its department with affirmed HEIs in Greece.
5. The External Assessment Group acknowledges that the Department demonstrated high levels of awareness of the steps that can be taken to improve quality culture.

**Weaknesses**

1. Regardless of marked improvements, the External Assessment Group concluded that for a rather not short period of time the study programme under review, alongside the department organizing it, operated with insufficient academic staff resources. It also concluded that the recruitment of academic staff with qualifications and scientific research outputs matching the disciplines of the courses they offer remains a challenge. It should be noted here that the doctoral programmes in the Republic of Albanian were frozen for several years in a row, thereby hindering the enhancement of qualifications of full-time staff with no doctoral degrees.
2. The teaching load of full-time academic staff members is substantial. While it does exceed the limit of supplementary hours provisions by the bylaws in force, it obliges them to deliver courses beyond their area of expertise.
3. No systematically fostered links with labour market actors from Albania or abroad, also attributed to the lack of curricular provisions for internships.
4. Quality culture seems still to be in its formative stages in this study programme both in terms of student evaluation of faculty, as well as with regards to peer-to-peer evaluation.

**Recommendations**

1. We suggest that the Department reviews the curriculum of the study programme to ensure that its elements fully comply with the bylaws in force.
2. We suggest that the Department looks into the possibilities to reduce the teaching load of its academic staff members, thereby enabling them to engage more substantially with scientific research and allow for a greater disciplinary affinity to the courses they deliver.
3. The Department is suggested to review the study suggested programme code in line with the Ministry of Education's conclusions thereof.



4. We recommend that the Department officially nominates a coordinator for each study programme it offers in case of an increase in the number of its students.
5. We also suggest that, upon curriculum review, the Department reflects on the possibilities to build tandem sequences in the various courses in the disciplines of Greek literature and civilization, thereby not merely extending students' knowledge, but also deepening it with a more evident comparative approach and more advanced concepts. In the field of Pedagogy, we suggest that the department reflects on the wisdom of reversing the current order of the courses titled "Teaching and Learning Setting in Primary Education" and "Introduction to Educational Science and Education Methods," so that the introductory course is delivered first. We also recommend that the department reflects on the pros and cons of enhancing the overall practice component of the study programme. It is also important that any curriculum review engages students and other actors from the labour market and elsewhere that could offer valuable contributions.
6. We suggest a more frequent review of the course syllabi, including the designation of more updated literature.
7. The External Assessment Group recommends that the Department reflects on the academic merit of revising the structure of the assessment regime by reducing the weight of the final exam and increasing the weight of other components of continuous assessment.
8. It is also recommended that the Department archives final exams and diploma theses for at least an accreditation cycle. The latter is also recommended to be kept in a database for the purpose of facilitating originality checks.
9. We also recommend the establishment of a Centre for Teaching and Learning on an institutional basis, aimed at raising the awareness levels of faculty on matters related to higher education pedagogy, leading to the improvement of their teaching performance.
10. We suggest that faculty members of the study programme target to publish their scientific outputs to internationally ranked journals (e.g., SCOPUS, Clarivate Analytics) and publishers (ranked in SENSE Academic Publishers).





**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>			X	